



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

Ministër i Shtetit për
Pushtetin Vendor

agjencia për mbështetjen

amvv

e vetëqeverisjes vendore

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS TË BASHKIVE 2024



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden

Sverige



HELVETAS





SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS TË BASHKIVE 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR
PUSHTETIN VENDOR



Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	10
Konteksti i Përgjithshëm.....	15
Ecuria nga Reforma e Fundit Administrativo-Territoriale	18
Të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuara	19
Shpenzimet.....	20
Detyrimet e prapambetura.....	21
Ofrimi i shërbimeve të transferuara në një dekadë	23
Metodologjia	24
Korniza analitike dhe kategorizimi i të dhënave.....	25
ECURIA E PROCESIT	26
1. Kuadri institucional dhe bazë ligjore	26
2. Dokumentet udhëzuese dhe metodologjike	27
3. Trajnimet dhe fuqizimi i kapaciteteve	27
4. Asistenca dhe monitorimi në terren	28
5. Lidhja e SMP-së me Grantin e Performancës.....	29
6. Komunikimi me bashkitë.....	29
7. Raportimi i bashkive	29
Menaxhimi Financiar, 2024	30
Realizimi i buxhetit dhe përdorimi i të ardhurave	31
Shërbimet, 2024	38
Arsimi	39
Shërbimet sociale	41
Menaxhimi i mbetjeve	45
Bujqësia.....	48
Pyjet dhe kullotat	50
Mbrojtja nga zjarri	52
Mirëqeverisja, 2024	54
Burimet njerëzore.....	55
Transparenca dhe llogaridhënia	58
Integrimi Evropian	59
Barazia gjinore	61
Sfida dhe Rekomandime	63
Anekset	68
Aneks A: Lista e miratuar e treguesve të SMP 2024	68
Aneks B: Tabela e klasifikimit/kategoritë	71



Aneks C: Menaxhimi Financiar	74
Aneks D: Shërbimet	99
Aneks E: Mirëqeverisja	149

Grafikët

GRAFIKU 1 PROGRESI I TË ARDHURAVE TË VETA NDAJ TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR 2015-2024	19
GRAFIKU 2: PROGRESI I SHPENZIMEVE TË PUSHTETIT VENDOR 2015-2024	21
GRAFIKU 3: PROGRESI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA 2015-2024	22
GRAFIKU 4: RAPORTI NË % I DETYRIMEVE NDAJ TË ARDHURAVE 2015-2024	22
GRAFIKU 5: BUXHETI, TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET, 2024	32
GRAFIKU 6: BUXHETI PËR FRYMË DHE REALIZIMI I BUXHETIT FAKT VS PLAN 2023-2024	33
GRAFIKU 7: TREGUESIT E TË ARDHURAVE TË BASHKISË, 2024	34
GRAFIKU 8: TË ARDHURAT E VETA PËR FRYMË DHE NË BUXHET 2023-2024	35
GRAFIKU 9: PËRDORIMI I TË ARDHURAVE DHE BUXHETIT, 2024	36
GRAFIKU 10: SHKALLA E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE DHE NDAJ BUXHETIT 2023-2024	36
GRAFIKU 11: INVESTIMET, 2024	37
GRAFIKU 12: INVESTIME PËR FRYMË 2023-2024	37
GRAFIKU 13: PESHA E SHPENZIMEVE TE PERSONELIT, OPERATIVE DHE INVESTIME NË BUXHET 2023-2024	38
GRAFIKU 14: INDIKATORI I ARSIMIT PARASHKOLLOR, 2024	39
GRAFIKU 15: TRENDI I REGJISTRIMIT NË ÇERDHE, 2023-2024	40
GRAFIKU 16: TRENDI I REGJISTRIMIT NË KOPSHTË, 2023-2024	41
GRAFIKU 17: TRENDI I RAPORTIT FËMIJË – MËSUES NË KOPSHTË, 2023-2024	41
GRAFIKU 18: TREGUESIT E SHËRBIMIT SOCIAL, 2024	43
GRAFIKU 19: TRENDI I TREGUESVE TË SHËRBIMIT SOCIAL	43
GRAFIKU 20: TREGUESIT E LIDHUR ME MENAXHIMIN E MBETJEVE, 2024	45
GRAFIKU 21: MENAXHIMI I MBETJEVE, 2023-2024	46
GRAFIKU 22: EFICIENCA E MENAXHIMIT TË SHËRBIMIT, 2024	47
GRAFIKU 23: TRENDI I SIPËRFAQES SË TOKËS BUJQËSORE MBULUAR ME SISTEM, 2023-2024	48
GRAFIKU 24: PERFORMANCA E BUJQËSISË SIPAS GRUPEVE TË BASHKIVE, 2024	49
GRAFIKU 25: TREGUESIT E MENAXHIMIT TË PYJEVE SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE, 2024	50
GRAFIKU 26: TRENDI I MBULIMIT ME PLANE MBARËSHTIMI, 2023-2024	51
GRAFIKU 27: TRENDI I PUNONJËSVE PËR SIPËRFAQE PYJORE, 2023-2024	51
GRAFIKU 28: TRENDI I TREGUESVE TË MZSH-VE, 2023-2024	52
GRAFIKU 29: NUMRI I ZJARRFIKËSVE DHE MJETEVE PËR BANORË, 2024	52
GRAFIKU 30: TRENDI I AUTOMJETEVE ZJARRFIKSE	53
GRAFIKU 31: BURIMET NJERËZORE, 2024	54
GRAFIKU 32: SHKALLA E ROTACIONIT 2023 DHE 2024	56
GRAFIKU 33: SHKALLA E TRAJNIMIT TË STAFIT NË BASHKI 2024	56
GRAFIKU 34: PUNONJËS PËR 1000 BANORË 2024	57
GRAFIKU 35: TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA 2024	58
GRAFIKU 36: INTEGRIMI EVROPIAN 2024	60
GRAFIKU 37: BARAZIA GJINORE 2024	61



Figurat

Figura 1: HARTA E SHQIPËRISË SIPAS PËRBËRJES SË TOKËS	42
Figura 2: HARTA E FAMILJEVE ME NDIHMË EKONOMIKE (NË %)	50

Tabelat

Tabela 1: VLERËSIMI I FUSHAVE	25
--------------------------------------	----



Parathënie

Z. Ervin Demo

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor

Nëntor 2025

Me kënaqësi ju paraqes raportin e performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2024, një dokument i cili vjen në një moment domethënës për qeverisjen vendore në vendin tonë. Ky raport ofron një pasqyrë të qartë të konsolidimit, progresit dhe sfidave me të cilat bashkitë përballen në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke shërbyer njëkohësisht si bazë e rëndësishme analitike për procesin e reformës së re territoriale.

Bashkitë janë ofruesit kryesorë të shërbimeve në territor dhe nga viti 2015 kanë shtuar përgjegjësitë me funksione shtesë duke rritur edhe kapacitetet e tyre ekonomike. Të ardhurat për frymë që prej vitit të parë të reformës janë 4-fishuar.

Sistemi i qeverisjes vendore në vend ka shënuar përmirësime të dukshme në parametrat e ofrimit të shërbimeve, të mbështetura nga avancimi i procesit të decentralizimit dhe integritimit evropian. Treguesit e performancës janë produkt i një procesi të koordinuar vendimmarrës mes institucioneve qendrore dhe pushtetit vendor, të cilët evidentojnë përmirësime domethënëse në tre fushat kryesore të vlerësimit: menaxhimin financiar, ofrimin e shërbimeve dhe mirëqeverisjen me fokus integrimin evropian.

Raporti paraqet rezultatet dhe evidenton progresin e bashkive, si dhe identifikon fusha ku janë të nevojshme përmirësime dhe ndryshime. Viti 2024 shënoi një pikë kthese për konsolidimin e qeverisjes së hapur në nivel vendor, pasi u zgjerua paketa e indikatorëve të performancës në kuadër të integritimit evropian. Ky zgjerim ka rritur standardet e transparencës, publikimit dhe monitorimit, duke e afruar më tej veprimtarinë e bashkive me kërkesat dhe praktikat e Bashkimit Evropian.

Jam i bindur se rezultatet e raportit do t'i nxisin bashkitë të reflektojnë mbi diferencat ekzistuese në performancë. Bashkitë e mesme dhe të mëdha, të cilat kanë avancuar më shumë në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe sigurimin e fondeve nga donatorët, mund të shërbejnë si shembull i mirë për ato më të vogla që ende ndodhen në fazat fillestare. Qëllimi kryesor mbetet forcimi i kapaciteteve vendore dhe funksionimi i të gjitha bashkive me standarde më të larta, për të ofruar shërbime më efektive dhe të qëndrueshme.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për të gjithë punonjësit e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Kryetarët e Bashkive dhe Kryetarët e Qarqeve. Gjithashtu dëshiroj të falenderoj partnerët tanë nga projekti “Bashki të Forta” i financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga HELVETAS.

Në pritje të diskutimit të këtij raporti me bashkitë, mbetem i përkushtuar për të ndërmarrë hapat e nevojshme për të çuar përpara progresin në të gjitha nivelet e Qeverisjes.





Përmbledhje ekzekutive

Viti 2024 përbën një moment të rëndësishëm në analizën e qeverisjes vendore në Shqipëri, pasi përkon me dhjetë vjet funksionim të bashkive sipas ndarjes së re administrativo-territoriale. Sistemi i Matjes së Performancës (SMP), i zbatuar në të 61 bashkitë e vendit, ofron një pamje të plotë dhe të krahasueshme mbi mënyrën se si administrohen burimet financiare, si ofrohen shërbimet e decentralizuara dhe sa të konsoliduara janë mekanizmat e mirëqeverisjes në nivel lokal.

Reforma e cila u shoqërua me funksione dhe financim shtesë rriti jo vetëm mundësitë por edhe përgjegjësinë në dhënien e shërbimeve publike. Në vitin 2024, performanca financiare është konsoliduar në nivel kombëtar pavarësisht sfidave që konstatohen nga analiza individuale e bashkive.

Pushtetit vendor në vitin 2024 ka realizuar shpenzime në vlerën 74.4 miliard lekë për ofrimin e shërbimeve publike, me një trend rritje të qëndrueshëm të tre viteve të fundit me rreth 12%. Kjo rritje e shpenzimeve publike, shkon jo vetëm në ruajtjen e standardit të shërbimeve publike vendore por edhe përmirësimit të tij.

Shpenzimet e buxhetit vendor krahasuar me Produktin e Brendshëm Bruto, janë rritur nga 2.4% në vitin 2015 para reformës, në 3.1% në vitin 2024.

Krahasuar me shpenzimet publike buxheti vendor nga 7.8% që ishte në vitin 2015 arriti në 10.2% në vitin 2024.

Sipas natyrës ekonomike të përdorimit të shpenzimeve, buxheti vendor në vitin 2024 rreth **45% është përdorur për shpenzime paga, 35% për shpenzime operative dhe 20% për investime.**

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor kanë rritje 241% krahasuar me 2015 kur filloi reforma administrativo-territoriale. Kjo rritje nga burimet e veta vjen nga mirëadministrimi dhe nga zhvillimi i potencialit ekonomik të familjeve e bizneseve në territor.

Në vitin 2014, 50% e NJVV-ve gjeneronin jo më shumë se 2% të buxhetit nga të ardhurat e veta, ndërkohë që në 2024 të ardhurat nga burimet e veta përbënin 54% të buxheteve të bashkive (kundrejt transfertave të pakushtëzuara). Rritja e pavarësisë financiare të një pjese të bashkive ka krijuar hapësirën e nevojshme që ata të jenë aktor aktivë në politikat publike.

Në 2024, të ardhurat e veta për frymë rezultojnë në vlerën **18,497 lekë/banorë**, ndërkohë që në 2015 ato ishin vetëm **4,634 lekë/banorë**, me një rritje prej rreth 3 fish në dekadën e fundit të analizës pas RAT. Kjo rritje e të ardhurave për banorë reflekton aftësinë e përmirësuar të bashkive për të gjeneruar burime, tregues i cili reflektohet në zgjerimin e ofrimit të shërbimeve dhe investimeve.

Taksa e pasurisë si burimi kryesor i të ardhurave të veta vendore është rritur me 84.6%, nga 3.9 miliardë lekë që ishte në vitin 2015, në 7.2 miliardë lekë në vitin 2024.

Ndërkohë mbështetja nga qeveria qendrore ka vazhduar në mënyrë intensive. Pushteti vendor nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale ka marrë në vitin 2024 aftësisht 38.3 miliard lekë ose 60% më shumë krahasuar me para reformës.



Detyrimet e prapambetura janë një ndër treguesit më të rëndësishëm të mirëmenaxhimit financiar, duke arritur të zvogëlojë vlerën e detyrimeve nga 12 miliardë lekë në vitin 2015, në rreth 3.1 miliardë lekë në vitin 2024.

Ndërkohë që ligji i huamarrjes vendore ka disiplinuar dhe përdorimin e kësaj forme financimi, sipas regjistrimit të borxhit publik **vetëm bashkia Elbasan ka rreth 23.9 milion lekë borxh të brendshëm publik**. Asnjë nga bashkitë e tjera nuk ka përdorur këtë formë të financimit për të mbështetur projekte zhvillimore.

Investimet për frymë për periudhën 2015 deri në 2024 janë rritur me 74%, përkatësisht nga 3,773 lekë në vitin 2015, në 6,376 lekë në vitin 2024.

Gjithashtu ky raport vlerëson performancën e kompetencave të transferuara në vitin 2016 që ofrojnë bashkitë: **arsimi parashkollor, ujitja/kullimi, pyjet/kullotat, mbrojtja nga zjarri, menaxhimi i rrugëve rurale dhe shërbimi social**. Të dhënat qartazi tregojnë përmirësime të dukshme në të gjitha këto funksione krahasuar me vitin 2023. Një dekadë decentralizimi konfirmon përmirësimin e ndjeshëm të shërbimeve në fushën e menaxhimit të sistemit ujitës – kullues; mbrojtjes nga zjarri dhe menaxhimit të mbetjeve. Rezultatet e matjes së performancës së këtyre shërbimeve pashmangshmërisht reflektojnë ndryshimet demografike; madhësinë dhe zhvillimin ekonomiko-social të bashkive. Kryesisht bashkitë e mesme dhe ato të mëdha si edhe ato me densitet më të lartë të numrit të bizneseve performojnë më mirë.

Arsimi parauniversitar

Në lidhje me arsimin parashkollor, raporti fëmijë-mësues është përmirësuar duke iu afruar mesatares së 27 vendeve të BE dhe i klasifikuar mirë krahasimisht me vendet e rajonit. Shkalla e regjistrimeve në çerdhe shënon trend pozitiv, nga 10% në 2023 në 12.5% në 2024.

Pabarazitë territoriale mbeten të forta, bashkitë e vogla kanë mbulim më të mirë, ndërsa bashkitë e mëdha (sidomos Tirana) vuajnë mbingarkesën e numrit të fëmijëve të regjistruar në arsimin parauniversitar dhe kërkesë për përmirësimin e infrastrukturës arsimore.

Ujitja dhe kullimi - Performanca ka përparuar ndjeshëm pas transferimit (sot raportohet nga bashkitë një sistem kanalesh gati 6 herë më funksional sesa viti 2015). Kullimi po ecën mirë për shkak të investimeve në zonat e përmbytjeve, ndërsa ujitja mbetet sfidë (50–65% funksionalitet real), pavarësisht përmirësimit vjetor të saj. Rritja e sipërfaqes së ujitshme ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e eksporteve bujqësore (+19% në 2024). Pengesa kryesore në këtë shërbim është paqartësia e pronësisë dhe mungesa e inventarit teknik.

Pyjet dhe kullotat - Vetëm 26 bashki kanë plane të mbarështimit, duke mbuluar rreth 42% të territorit pyjor të këtyre bashkive me plan ose 24% të të gjithë sipërfaqes pyjore në zotërim nga bashkitë. Sfidat e këtij shërbimi është rritja e mbulimit me plane mbarështimi dhe zbatimi real i tij, monitorimi i pyjeve nga përdorimi i paligjshëm dhe fatkeqësitë natyrore.

Mbrojtja nga zjarri - Kapacitetet e bashkisë për ofrimin e këtij shërbimi po rriten. Numri i zjarrfikësve është dyfishuar krahasuar me një dekadë më parë dhe është shumë pranë standartit të BE-së. Të gjitha bashkitë kanë tashmë stacione, por nevojitet ndërhyrje në flotën e



automjeteve. Tirana, sërish, rezulton me risk në ofrimin e shërbimit për shkak të dendësisë, objekteve kritike dhe kohëve të gjata të lëvizjes.

Menaxhimi i mbetjeve - Mbulimi urban me shërbim është pothuajse i plotë, ndërsa zona rurale mbetet problem (65% mbulim). Mbulimi kombëtar i shërbimit është 85.6% dhe me një rritje të konsiderueshme krahasuar me një dekadë më parë. Gjenerimi i mbetjeve gjatë një viti rezultoi 357 kg/frymë në 2024, shumë më i ulët se BE. Menaxhimi financiar i shërbimit është përmirësuar, për shkak të grumbullimit më të mirë të tarifës dhe për rrjedhojë kosto e 1 ton mbetje urbane është ulur. Disa bashki mbledhin të ardhura më të larta se shpenzimi real që bëjnë për menaxhimin e mbetjeve duke shtuar në mënyre artificiale barrën fiskale për këtë shërbim.

Shërbimi social - Shërbimi social është sektori që ekspozon më fort pabarazinë territoriale dhe kapacitetet e dobëta institucionale. Bashkitë reagojnë më shumë se sa planifikojnë realisht në buxhetet e tyre. Pjesa më e madhe e ndërhyrjeve ka karakter emergjence (ndihma ekonomike, raste urgjente), ndërsa shërbimet social-kurative (PAK, strehim, dhuna) vuajnë nga mungesa e infrastrukturës dhe stafit profesionist.

Shperndarja e Ndhmës Ekonomike varion ndjeshëm: bashkitë e vogla kanë norma të larta (varfëri strukturore dhe mungesë punësimi), ndërsa bashkitë urbane kanë norma të pranueshme. Gjithsesi numri i përfituesve është ulur ndjeshëm krahasuar me një vit më parë duke reflektuar zhvillimet pozitive në ekonominë shqiptare, punësimin si edhe rënien e numrit të popullsisë.

Strehimi social është përmirësuar por ende bashkitë nuk balancojnë më shumë sesa 40% të kërkesave të popullatës për këtë shërbim. Performancë më të mirë kanë bashkitë e mëdha ku edhe buxhetet e bashkisë mund të realizojnë banesa sociale.

Gjithashtu është rritur përqindja e personave të shërbyer kundrejt rasteve të referuara si për rastet e dhunës ashtu edhe për personat me aftësi të kufizuar. Rastet e dhunës gjejnë zgjidhje shumë më shpejt sesa rastet e personave PAK, te cilat mbeten në nivele shumë të ulëta shërbimi.

Përsa i përket mirëqëverisjes, viti 2024 paraqet një tablo më të strukturuar dhe më të qartë të mënyrës se si bashkitë po përballen me standardet e reja të administrimit publik. Vlerësimi është zhvilluar në katër dimensionet kryesore: **burimet njerëzore, transparencja, integriteti evropian dhe barazia gjinore**, të cilat së bashku ofrojnë një kuptim të plotë të kapacitetit institucional të bashkive për të qeverisur në mënyrë efektive.

Burimet njerëzore - Menaxhimi i burimeve njerëzore mbetet një nga elementët më përcaktues të cilësisë së qeverisjes vendore. Viti 2024 shënoi një stabilizim të ndjeshëm të rotacionit të stafit në nivel kombëtar, duke sinjalizuar rritje të sigurisë institucionale dhe reduktim të lëvizshmërisë së burimeve njerëzore. Përveç kësaj, është vërejtur një rritje e përfshirjes në programe trajnimi dhe zhvillimi profesional, çka reflekton përpjekjet e bashkive për të rritur kompetencat teknike të stafit.

Megjithatë, kapacitetet ndërmjet bashkive janë të pabarabarta. Bashkitë e mëdha shfaqin administrata më të qendrueshme, me raport staf/banor më efikas dhe me nivele më të ulëta rotacioni, duke krijuar mundësi për ndërtimin e kujtesës institucionale dhe përmirësimin e



vazhdueshëm të shërbimeve. Në të kundërt, bashkitë e vogla përballen me mungesë stafi, pozicione të pambuluara dhe ngarkesë disproporcionale për punonjësit ekzistues, duke reflektuar sfida të qëndrueshme në rekrutim, mbajtje dhe trajnime.

Transparenca - Viti 2024 përbën një pikë kthese në konsolidimin e qeverisjes së hapur në nivel vendor. Bashkitë e mëdha rezultuan më të përgatitura për të përmbushur këto kërkesa të reja, falë kapaciteteve më të konsoliduara teknike dhe burimeve të nevojshme për hartimin e publikimin e dokumenteve strategjike. Ndërkohë, bashkitë e vogla dhe disa bashki të mesme përballen me mungesë ekspertize, staf të limituar dhe sfida teknike për të realizuar publikime dhe konsultime të rregullta, duke reflektuar një hendek të qëndrueshëm në zbatimin e standardeve të qeverisjes së hapur. Megjithatë, prirja kombëtare mbetet pozitive dhe tregon orientim të qartë drejt rritjes së llogaridhënies publike.

Integrimi evropian - Për herë të parë, viti 2024 solli matjen e dimensionit të integritit evropian në nivel bashkie. Ky është një zhvillim thelbësor që tregon se roli i bashkive në procesin e afrimit të vendit me Bashkimin Evropian po forcohet dhe po matet në mënyrë sistematike. Treguesit e rinj përfshijnë: marrëveshjet ndërbashkiake, kapacitetet për projektet e BE-së, funksionimin e strukturave të brendshme, sipas manualeve orientuese të AMVV-së dhe ngritjen e komisioneve të integritit në këshillat bashkiakë.

Rezultatet tregojnë një profil të larmishëm. Disa bashki të mesme dhe të mëdha kanë ndërtuar struktura funksionale për hartimin e projekteve, bashkëpunimin ndërinstitutional dhe koordinimin me partnerë evropianë, duke shfaqur aftësi konkurruese në sigurimin e projekteve të financuara. Përkundrazi, shumë bashki të vogla ende ndodhen në fazat e para të zhvillimit të kapaciteteve, si pasojë e mungesës së stafit dhe burimeve financiare, duke sinjalizuar nevojën për mbështetje shtesë dhe programe të posaçme trajnimi.

Barazia gjinore - Barazia gjinore mbetet një nga treguesit më domethënës të cilësisë së qeverisjes. Përfaqësimi i grave në administratën vendore ka shënuar progres të ndjeshëm, duke arritur mesatarisht **33.7%**, ndërsa në bashkitë e mëdha dhe në Tiranë niveli ngjitet në rreth **40%**. Në pozitat e ulëta dhe të mesme drejtuese, bashkitë e mëdha kanë mbi **50%** gra, duke reflektuar një kulturë institucionale që promovon meritokracinë dhe përfshirjen gjinore në proceset vendimmarrëse.

Megjithatë, bashkitë e vogla paraqesin nivele dukshëm më të ulëta të përfaqësimit të grave, për shkak të tregut më të kufizuar të punës, mungesës së mundësive profesionale dhe kapaciteteve të reduktuara për të zhvilluar politika të brendshme që nxisin barazinë. Kjo pabarazi strukturale sugjeron se ndërhyrjet duhet të jenë të targetuara dhe të diferencuara sipas madhësisë dhe potencialit ekonomik të bashkive.

Në përgjithësi vlen të theksohet se viti 2024 paraqet një pamje të qartë të progresit dhe sfidave të qeverisjes vendore. Bashkitë po bëhen më të afta në menaxhimin e financave, po investojnë më shumë në shërbime dhe po përmirësojnë instrumentet e mirëqeverisjes. Por përparimi është asimetrik, bashkitë e mëdha dhe ato me potencial ekonomik më të lartë, shfaqin performancë më të qëndrueshme, ndërsa bashkitë e vogla mbeten më të ekspozuara ndaj kufizimeve institucionale, financiare dhe demografike.



Ky vlerësim nënvizon nevojën për politika të diferencuara mbështetëse, investime në burime njerëzore, digjitalizim dhe rritje të autonomisë fiskale, që së bashku mund të çojnë drejt një qeverisjeje vendore më efektive, më të paanshme dhe më të qëndrueshme në gjithë territorin e vendit.



Konteksti i Përgjithshëm

Ky raport paraqet një analizë të performancës të bashkive për vitin 2024, duke vlerësuar aspekte që lidhen me ofrimin e shërbimeve, menaxhimin financiar, burimet njerëzore, qeverisjen dhe transparencën. Në këtë dokument vihen në dukje arritjet dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Gjetjet mbështeten në Sistemin e Matjes së Performancës (SMP), ku janë vlerësuar 61 bashkitë për 51 tregues performance pasi treguesi i lidhur me përqindjen e buxhetit vendor të alokuar për nisma që mbështesin barazinë gjinore në secilin program buxhetor vendor nuk u arrit të disponohej.

Vlen të theksohet se zhvillimi i Sistemit të Matjes së Performancës për bashkitë dhe raporti i vitit 2024 janë të mbështetura në një kornizë të qartë ligjore dhe institucionale, të ndërtuar gjatë dekadës së fundit me synimin për të forcuar vetëqeverisjen vendore, për të rritur autonominë financiare të bashkive dhe për të garantuar ofrimin e shërbimeve publike sipas standardeve kombëtare. Nëpërmjet këtij kuadri, SMP shndërrohet në një instrument operativ që mat se sa mirë po materializohen në praktikë parimet e reformës administrativo-territoriale, të decentralizimit dhe të zhvillimit rajonal e territorial.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përbën shtyllën themelore të kuadrit ligjor, pasi përcakton qartë kompetencat e bashkive mbi të cilët është ndërtuar edhe SMP. Çdo grup treguesish, në thelb, mat se sa mirë po ushtrohen kompetencat që ky ligj u ka ngarkuar bashkive. Në këtë kuptim, SMP nuk është thjesht një instrument statistikor, por është një mekanizëm ligjor i llogaridhënies së bashkive për ushtrimin e kompetencave të tyre, siç përkufizohen nga Ligji nr. 139/2015.

Një shtyllë tjetër e rëndësishme e kuadrit ligjor lidhet me financat e vetëqeverisjes vendore (ligjet dhe aktet nënligjore për financat vendore, për menaxhimin e borxhit dhe për buxhetimin afatmesëm). SMP bazohet mbi këto parime për të matur një sërë treguesish, si të ardhurat e veta dhe peshën e tyre ndaj buxhetit total, transfertat e pakushtëzuara nga qeveria qendrore, detyrimet e prapambetura dhe reduktimin e tyre gjatë dekadës si dhe investimet për frymë dhe raportin e investimeve ndaj të ardhurave vendore.

Ligji nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin” vendos bazën ligjore për politikën e zhvillimit rajonal. Ai synon reduktimin e pabarazive territoriale dhe integrimin e politikave sektoriale në një qasje të unifikuar zhvillimi. SMP ofron të dhëna krahasuese ndërmjet bashkive në shkallë kombëtare, të cilat mund të ripërdoren nga institucionet përgjegjëse për zhvillimin rajonal për identifikimin e pabarazive territoriale dhe zonave me performancë të ulët. Matja e cilësisë së shërbimeve (ujitja-kullimi, pyjet, mbetjet, shërbimet sociale) krijon një bazë evidencash që mund të përdoret për prioritarizimin e ndërhyrjeve rajonale dhe projekteve të kohezionit. Përdorimi i të dhënave të Cens 2023 në këtë raport ofron një pasqyrë demografike dhe territoriale që mund të shërbejë si input për Planet Rajonale të Zhvillimit dhe për Planin Kombëtar të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit, edhe pse vetë raporti nuk fokusohet në analiza të detajuara në nivel qarku apo rajoni.

Në të njëjtën linjë, Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar siguron bazën ligjore për integrimin midis planifikimit hapësinor (PPK, PPV) dhe zhvillimit ekonomik e social. Treguesit e SMP, sidomos ata për infrastrukturën e shërbimeve,



menaxhimin e mbetjeve dhe pyjet, janë në funksion të këtij integrimi, pasi tregojnë nëse zhvillimi territorial dhe planifikimi hapësinor po përkthehen realisht në akses më të mirë në shërbime për qytetarët.

Për më tepër zbatimi i kësaj kornize ligjore mbështetet në një arkitekturë institucionale me shumë nivele, ku Sistemi i Matjes së Performancës luan rol lidhës midis aktorëve qendrorë, rajonalë dhe vendorë. Në nivel qendror, rolin kryesor e luan **Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor (MSHPV)/Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)**, i cili, ka marrë përsipër nismën për matjen e performancës dhe ka koordinuar procesin e përzgjedhjes së treguesve, përgatitjen e metodologjisë dhe komunikimin zyrtar me bashkitë.

Përgatitja e raportit ka qenë e mbështetur teknikisht nga partnerët ndërkombëtarë (“Bashki të Forta”), ndërsa zhvillimi i 52 treguesve është miratuar nga **Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP)**, ku u përfshinë 11 ministri, shoqatat e qeverisjes vendore, si dhe disa organizata ndërkombëtare dhe institucione qendrore.

Të dhënat për secilën bashki, edhe pse nuk paraqiten në formë analize për qark, mund të grupohen dhe interpretohen nga këto institucione për të vlerësuar pabarazitë brenda rajonit, performancën e bashkive më të dobëta dhe nevojën për ndërhyrje të synuara në shërbime, infrastrukturë apo kapacitete menaxheriale.

Vlen të theksohet se SMP 2024, përfaqëson ushtrimin më të gjerë të matjes së performancës në qeverisjen vendore në dekadën pas Reformës Territoriale dhe përputhet ngushtë me objektivat e dokumenteve strategjike të zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030 (SNDQV) është dokumenti më i lidhur drejtpërdrejt me SMP, pasi ajo adreson funksionet dhe kompetencat e transferuara nga qeverisja qendrore tek ajo vendore, të cilat matin po këta tregues. SNDQV synon rritjen e autonomisë fiskale dhe administrative, forcimin e kapaciteteve vendore, profesionalizimin e administratës dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve. Këto objektiva gjejnë pasqyrim të plotë në raport nëpërmjet treguesve specifik si rritja e të ardhurave të veta, ulja e detyrimeve të prapambetura dhe orientimi i buxheteve drejt investimeve dhe shërbimeve të cilët tregojnë konsolidimin e pushtetit vendor në linjë me objektivat e strategjisë. Puna me burimet njerëzore, rotacioni i stafit, niveli i trajnimeve dhe raporti punonjës/banor lidhen drejtpërdrejt me shtyllën e SNDQV për ndërtimin e administratës vendore profesionale. Matjet e transparencës, konsultimeve dhe qeverisjes me standarde janë elementë kyç të strategjisë dhe reflektojnë gjendjen reale të qeverisjes vendore. Për më tepër, fusha si arsimit parashkollor, ujitja-kullimi, pyjet e kullotat dhe mbrojtja nga zjarri janë të monitoruara në detaje në raportin e performancës, çka e bën atë një mjet operacional të SNDQV dhe një kontribut të drejtpërdrejtë në zbatimin e saj.

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 gjen mbështetje në SMP, i cili përfshin një nga matjet më të detajuara mbi arsimin parashkollor që është bërë në nivel kombëtar. Strategjia e Arsimit kërkon rritje të aksesit në edukimin e hershëm, rritjen e cilësisë së infrastrukturës dhe përmbushje të standardeve të raportit mësues/fëmijë. Treguesit e SMP, përfshirë shkallën e regjistrimit në çerdhe dhe kopshte, mirëmbajtjen e objekteve arsimore dhe raportin fëmijë/mësues, janë drejtpërdrejt të ndërlidhur me objektivat e strategjisë.



Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027 mbulon menaxhimin e tokës, ujitjen, kullimin dhe zhvillimin rural, të gjitha funksione të matura nga raporti i performancës. Raporti evidenton gjithashtu sfidat me menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, duke reflektuar drejtpërdrejt objektivat e strategjisë për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 pasqyrohet nëpërmjet treguesve për përfaqësimin e grave në pozicione drejtuese. Dallimet pozitive në bashkitë e mëdha tregojnë një progres të ndjeshëm drejt objektivave të strategjisë, që kërkon rritje të barazisë dhe fuqizimin e grave në vendimmarrje. Raporti ofron analizë sipas madhësisë së bashkisë, duke e bërë të mundur monitorimin e barazisë gjinore në nivel vendor, një nga boshllëqet historike të politikave publike.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023–2030 reflektohet përmes treguesve të transparencës (publikimet online, konsultimet publike, qasja në informacion), të cilët pasqyrojnë zbatimin praktik të strategjisë kundër korrupsionit në nivel vendor. Bashkitë që performojnë më mirë në transparencë janë në linjë me objektivin e strategjisë për rritje të përgjegjshmërisë institucionale dhe reduktim të praktikave të rrezikshme.

Në procesin e decentralizimit, raporti ofron një pasqyrë të qartë mbi autonominë financiare të bashkive, mbi kapacitetet e tyre administrative, mbi ushtrimin e funksioneve dhe mbi cilësinë e qeverisjes vendore. Rëndësia e tij qëndron edhe në faktin se mundëson vlerësimin e progresit të decentralizimit në mënyrë të matshme dhe të krahasueshme.

SMP është i rëndësishëm edhe për shkak se lejon një lexim ndërsektorial të territorit, që nga aspekti i politikave të zhvillimit ekonomik lokal, zhvillimin rural, orientimin e politikave sociale dhe cilësinë e qeverisjes demokratike. Me këtë qasje gjithëpërfshirëse, raporti shndërrohet në një instrument planifikues multifunksional, i cili mund të përdoret nga qeveria qendrore, ashtu edhe nga vetë bashkitë, qarqet, donatorët, agjencitë zhvillimore dhe partnerët ndërkombëtarë.

ECURIA NGA REFORMA E FUNDIT ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE




Ecuria nga Reforma e Fundit Administrativo-Territoriale

Të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuara

Ndërhyrjet e zhvilluara 10 vite më parë (në vitin 2015) përmes reformës administrativo-territoriale, shënuan ndryshime të rëndësishme jo vetëm organizative, por edhe në konsolidimin e menaxhimit financiar publik të pushtetit vendor. Kjo reformë kishte qëllim kthimin e pushtetit vendor në qendër të zhvillimit lokal dhe shërbimeve cilësore, e cila do të arrihej përmes forcimit të qeverisjes vendore në përgjegjësitë e funksioneve shtesë por edhe decentralizimit financiar që siguronte më shumë burime financiare në dispozicion dhe autonomi vendimmarrëse. Në këndvështrimin e performancës financiare, në këtë seksion është analizuar trendi i ndryshimeve financiare të pushtetit vendor, duke paraqitur një kontekst të argumentuar të fenomeneve që sollën zhvillimet historike në nivel vendor.

GRAFIKU 1: PROGRESI I TË ARDHURAVE TË VETA NDAJ TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR 2015-2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Pushteti vendor në Shqipëri financohet nga disa burime të ndryshme, të cilat ndahen në të ardhura nga burime të vetat, transfertat të buxhetit qendror dhe donacione nga partneritete e projekte të ndryshme. Ndërkohë që në vitin 2015 të ardhurat e veta të bashkive krahasuar me transfertat ndërqeveritare ishin vetëm 36%, ky tregues është përmirësuar me kalimin e viteve si pasojë e rritjes së kapacitetit fiskal. Rritja graduale e peshës së të ardhurave të veta ndaj transfertave të buxhetit qendror pas RAT, ku në vitin 2024 rezulton në 54%, konsiderohet si një ndër rezultatet më të rëndësishme drejt rritjes së autonomisë financiare për vetëqeverisjen vendore.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i performancës të bashkive mbetet në të ardhurat e veta të bashkive. Që prej reformës territoriale të vitit 2015, bashkitë kanë pësuar rritje të ndjeshme të të ardhurave të veta duke arritur tre-fishimin e tyre në vitin 2024, tregues ky thelbësor i



zhvillimit por edhe i konsolidimit të kapaciteteve financiare. Pushteti vendor nga 13 miliardë lekë që mbledhte në vitin 2015, mbledh nga burimet e veta 44 miliardë lekë në vitin 2024.

Në vitin 2024, bashkia me autonominë më të lartë por edhe të konsoliduar në kohë është ajo e Tiranës, ku 83% e shpenzimeve që ajo realizon, mbulohen nga të ardhurat vendore. Pas kësaj bashkie, si pasojë e të ardhurave që vijnë në një peshë të madhe nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, autonomi financiare në vitin 2024 kanë shënuar bashkia Sarandë me 75%, Himarë me 68% dhe bashkia Kamëz me rreth 67%. Këto bashki mbledhin të ardhura të mjaftueshme për politika publike e për të financuar aktivitetet dhe investimet e tyre në infrastrukturë e shërbime cilësore. Ndërkohë që në 2015, bashkitë Tiranë (22%), Himarë (59%) dhe Sarandë (37%) kanë patur vlera mjaft të ulëta të këtij treguesi.

Treguesit paraqesin në mënyrë të qartë transformimin financiar të pushtetit vendor 2015–2024, ku rritja e të ardhurave të veta dhe dinamika e transfertave nga buxheti i shtetit pasqyrojnë një proces të dukshëm të decentralizimit fiskal. Në vitin 2015, bashkitë mbështeteshin kryesisht te transfertat qendrore, ndërsa të ardhurat e veta përfaqësonin një bazë të kufizuar. Në vitin 2024, të ardhurat e veta janë rritur me 241%, një ritëm shumë më i shpejtë se sa rritja e transfertave qendrore (+59.5%). Bashkitë janë bërë më aktive në mobilizimin e burimeve të tyre përmes taksave vendore, tarifave dhe menaxhimit më efikas të aseteve. Rritja e të ardhurave të veta pasqyron edhe përmirësime në administrimin fiskal vendor, zgjerimin e bazës së tatimpaguesve dhe urbanizimin e shpejtë në disa bashki të mëdha.

Ndryshimet e popullsisë kanë reflektuar impakt, por nëse në analizë do të marrim të ardhurat e veta për frymë gjatë kësaj periudhe, vihen re ndryshime pas reformës kryesisht në bazë të shtrirjes territoriale. Në 2024 të ardhurat e veta për frymë llogariten në vlerën 18,497 lekë/banorë, ndërkohë që në 2015 ato rezultonin vetëm 4,634 lekë/banorë..


Treguesit e buxhetit vendor kanë përmirësuar edhe krahasuar me ato të nivelit kombëtar si Produkti i Brendshëm Bruto apo Shpenzimet Publike. Shpenzimet vendore janë 3% të Produktit të Brendshëm Bruto dhe 10.2% të shpenzimeve publike në vitin 2024, me një rritje performance krahasuar me vitin 2015 para RAT kur këto tregues ishin përkatësisht 2.3% dhe 7.7%.

Shpenzimet

Cilësia e ofrimit të shërbimeve publike është thelbësore në këndvështrimin e performancës së bashkive, e kjo arrihet ndër të tjera edhe me një situatë të shëndoshë financiare. Shpenzimet vendore, që rriten dhe përkthehen në shërbime publike me standarde më të larta janë qartësisht objektiv qendror i menaxhimit mbi bazë performance.



GRAFIKU 2: PROGRESI I SHPENZIMEVE TË PUSHTETIT VENDOR 2015-2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Nga viti 2015 ku u miratua RAT deri në vitin 2024, shpenzimet faktike të pushtetit vendor kanë shënuar një rritje të konsiderueshme prej 122%, tregues ky që tregon ecuri pozitive në financimin e shërbimeve publike dhe mbështetjen për zhvillimin vendor.

Ky trend rritës i shpenzimeve të njërive të vetëqeverisjes vendore me burim financimi (të ardhurat e veta, transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe taksat e ndara) arrin vlerën 75.6 miliardë lekë në 2024, rreth 7.6 miliardë lekë më shumë se në 2023 dhe rreth 31 miliardë më shumë se në 2015. Rritja e shpenzimeve vendore qartësisht reflekton një qendrueshmëri në stabilitetin financiar të njërive vendore. Presioni për investime të shtuara dhe shërbime publike cilësore ka rritur nevojën për financim e burime të shtuara në dispozicion.


Në disa bashki, rritja e shpenzimeve është drejtuar kryesisht nga shpenzimet korrente, që përbëjnë një pjesë të madhe të buxhetit. Në këtë kuptim, *grafiku reflekton jo vetëm zgjerimin financiar të pushtetit vendor, por edhe sfidën e tij më të madhe të menaxhimit të shpenzimeve në mënyrë më të balancuar dhe të orientuar drejt rezultateve.*

Krahasuar me treguesit kombëtar të Produktit të Brendshëm Bruto dhe Shpenzimet Publike performanca financiar është rritur, pavarësisht përpjekjeve për të impaktuar më shumë në shërbimet vendore. Në vitin 2024 shpenzimet vendore janë rreth 3% të PBB-së dhe vetëm 10.2% të shpenzimeve publike. Krahasuar me vitin 2015 para RAT, këto dy tregues janë rritur përkatësisht 2.4% dhe 0.7% në vitin 2024.

Detyrimet e prapambetura

Në konceptin e performancës ky është një ndër treguesit më të rëndësishëm se si një bashki jo vetëm ofron shërbime cilësore në rritje, por arrin ta bëjë atë në mënyrë eficiente duke siguruar gjithashtu edhe performancë financiare. Në këtë aspekt rënia e detyrimeve me 75% nga perioda para reformës deri në vitin 2024 tregon përmirësim të menaxhimit financiar të bashkive.

GRAFIKU 3: PROGRESI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA 2015-2024




Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Mirëadministrimi financiar i bashkive pas RAT u reflektua drejtpërdrejt në reduktimin e detyrimeve ndaj të tretëve të papaguara nga bashkitë. Duke vlerësuar në seri kohore detyrimet e prapambetura për periudhën 2015-2024, rezulton një përmirësim i ndjeshëm përmes uljes së tyre nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto detyrime të prapambetura në 2024 janë katërfish më pak në krahasim me vitin 2015, përkatësisht nga rreth 12 miliardë lekë në rreth 3 miliardë lekë në 2024. Pas reformës administrativo-territoriale, pushteti vendor në monitorimin e Ministrisë së Financave performoi shumë mirë në reduktimin e detyrimeve që trashëguan nga ish-njësitë e vetëqeverisjes vendore të mëparshme.

Bashkitë si pasojë e mirëmenaxhimit por edhe kuadrit ligjor kanë një borxh publik prej vetëm 23.9 milion lekë në fund të vitit 2024, ku krahasuar me vitin 2015 borxhi publik ishte rreth 940 milion lekë ose shumëfish më i madh. Krijimi i mekanizmave shpesë të borxhit, që i japin hapësirë financimi bashkive me cilësi të lartë të menaxhimit financiar, është një formë për të nxitur rolin e bashkive në politikën zhvillimore. Në shumë raste mungesa e instrumenteve kanë krijuar penalitete në humbjen e kapacitetit të bashkive për tu kthyer në aktor të rëndësishëm të projekteve zhvillimore.

GRAFIKU 4: RAPORTI NË % I DETYRIMEVE NDAJ TË ARDHURAVE 2015-2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV



Ofrimi i shërbimeve të transferuara në një dekadë

Reforma administrative-territoriale solli kompetenca të zgjeruara në lidhje me funksionet e njësive të qeverisjes vendore. Gjashtë funksione të reja iu dhanë bashkive: arsimi parashkollor tërësisht në funksionim të bashkive; menaxhimi i pyjeve dhe kullotave; menaxhimi i sistemit ujitës-kullues; menaxhimi i rrugëve rurale; shërbimet sociale dhe mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi.

Në këtë raport performance kemi mundësinë të vlerësojmë disa nga këto shërbime sesi kanë performuar në këtë dekadë decentralizim.

Të dhënat e vitit 2024 tregojnë përmirësime të forta strukturore (përkatësisht 4.5 – 6.5 herë rritje kundrejt shërbimit të realizuar në vitin 2015) në saj të investimeve dhe punës operacionale nga bashkitë.

Bashkitë ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane duke mbuluar pothuajse tërësisht zonën urbane dhe në një nivel që ka nevojë për përmirësim, zonën rurale. Të gjitha bashkitë kanë ngritur së paku një stacion zjarrfikëse për ushtrimin e funksionit.

Për gati një dekadë tashmë bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave. Në janar 2016 bashkitë së bashku me sipërfaqet pyjore morën edhe 103 punonjës nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, dhe transfertë specifike nga buxheti i shtetit për të ofruar këtë shërbim. Sot, bashkitë kanë më shumë punonjës në dispozicion për menaxhimin dhe monitorimin e pyjeve dhe kullotave duke u përafruar me standartet evropiane edhe pse trashëguan një numër shumë të vogël punonjësish në momentin e decentralizimit.

Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi si shërbim u transferua nga Ministria e Brendshme tek bashkitë më 1 janar 2016 kur në atë kohë vetëm 36 bashki morën stacione të MZSh ndërkohë që personeli u shpërnda tek të gjitha bashkitë. Për rrjedhojë 35 bashkive fillimisht iu desh të krijonin shërbimin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi. Në vijim të Reformës Administrative Territoriale, në përfundim të vitit 2018 u arrit që të gjitha bashkitë të kishin stacione zjarrfikëse, me personel minimal prej 14 punonjësish (kusht ky i ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”¹).

Shërbimet sociale mbetet sfida më e madhe e bashkive ku duhet të përballen me kërkesa të ndryshme për popullsinë në nevojë. Qeverisja vendore ka kaluar në një nivel tjetër, nga ofrimi i shërbimeve tradicionale si Ndihma Ekonomike, në shërbime sociale të organizuara në qendra ditore dhe rezidenciale madje duke ofruar edhe shërbim social të lëvizshëm pranë familjeve me profesionistë të specializuar si mjekë; psikolog; punonjës social; fizioterapist; logoped etj.

Thënë kjo bashkitë kanë bërë shumë, por sfidat mbeten të mëdha. Ato përveç nevojës për të arritur me shërbime tek cdo qytetar duhet të sigurojnë që politikat e tyre do ti adresojnë problemet që vijnë nga rënia e popullatës dhe mbështetjes së një ekonomie vendore që prodhon brenda standarteve të tregut evropian.

¹ MZSH duhet të ketë 1 punonjës për 1,500 – 2,000 banor por jo më pak se 14



Metodologjia

Përgatitja e Raportit të Performancës së Bashkive 2024 është bazuar në një metodologji të strukturuar, të unifikuar dhe të dakordësuar ndërinstytucionalisht, me synim sigurimin e krahasueshmërisë ndërmjet bashkive dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara. Metodologjia mbështetet në Sistemin e Matjes së Performancës (SMP), i cili përcakton qartë fushat e vlerësimit, treguesit përkatës, mënyrën e mbledhjes, verifikimit dhe analizimit të të dhënave.

Procesi metodologjik është konceptuar si një ushtrim gjithëpërfshirës, ku janë angazhuar aktorë kryesorë të qeverisjes qendrore dhe vendore, përmes Grupit Ndërinstytucional të Punës dhe grupeve teknike, si dhe përfaqësues të shoqatave të njësisve vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ky konfigurim siguron që treguesit të reflektojnë jo vetëm kërkesat ligjore dhe prioritetet kombëtare, por edhe realitetin praktik të ofrimit të shërbimeve në territor.

Metodologjia përfshin disa faza të dallueshme nga përzgjedhja dhe dizenjimi i treguesve, konsultimet me qeverisjen vendore, trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve, mbledhja dhe sigurimi i cilësisë së të dhënave, deri te paraqitja analitike e rezultateve.

Për të mundësuar krahasimet, metodologjia mbështetet gjithashtu në një kornizë analitike të posaçme, që klasifikon bashkitë sipas madhësisë së popullsisë, dendësisë së bizneseve dhe kompozitës së tokës. Kjo qasje lejon që rezultatet të interpretohen jo vetëm në mënyrë të përgjithshme kombëtare, por edhe në funksion të karakteristikave strukturore të secilës bashki, duke nxjerrë më qartë në pah specifikat dhe pabarazitë në ofrimin e shërbimeve dhe ushtrimin e kompetencave vendore.

Më konkretisht, procesi SMP rezultoi në mbledhjen e të dhënave përmes një instrumenti digjital sipas treguesve specifikë. Treguesit u përzgjedhën për të mbuluar një fushë të gjerë funksionesh dhe përgjegjësisë të bashkive. Edhe pse vlerësimi ofron informacione të vlefshme në lidhje me performancën e bashkive, ekzistojnë kufizime në të dhëna, që duhen marrë parasysh kur analizohen gjetjet:

- 1. Të dhënat** e përdorura në këtë raport janë të kombinuara, nga bashkitë dhe institucionet qendrore dhe pavarësisht përpjekjeve për të verifikuar dorëzimet, ekziston mundësia e pasaktësive ose raportimeve të gabuara.
- 2. Mungesa e regjistrave/sistemeve administrative:** Cilësia e të dhënave dhe plotësia e tyre sigurohet nëpërmjet pasjes së regjistrave kombëtarë sipas shërbimeve dhe funksioneve.
- 3. Inkoherencat në raportimin e të dhënave:** Mungesa e cilësisë për disa të dhëna, e cila u evidentua gjatë fazës së përpunimit dhe analizimit, ka çuar në rishikimin dhe korrigjimin e disa prej të tyre, në mbështetje me burime të tjera zyrtare.

Të gjithë treguesit janë analizuar dhe përpunuar në përputhje me rezultatet e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2023. SMP vlerësoi performancën e bashkive në fushat e mëposhtme:



1. **Menaxhimi Financiar:** Të ardhurat e veta, borxhi, realizimi i buxhetit dhe rikuperimi i kostove.
2. **Performanca e Shërbimeve:** Arsimi parauniversitar, shërbimet sociale, menaxhimi i integruar i mbetjeve, bujqësi, menaxhimi i pyjeve dhe kullotave dhe mbrojtja nga zjarri.
3. **Mirëqeverisja:** Transparenca, barazia gjinore, menaxhimi i burimeve njerëzore si dhe përdhithja e fondeve të huaja.

Në vijim paraqiten hapat kryesorë të ndjekur në ndërtimin dhe zbatimin e metodologjisë së SMP për vitin 2024:

TABELA 1: VLERËSIMI I FUSHAVE

Vlerësimi i fushave	
Përmbushja e kompetencave të veta	Përmbushja e kompetencave të veta
	Në kontrollin e bashkisë
	E rëndësishme nga pikëpamja financiare
Prioritet kombëtar	Prioritet Kombëtar
	Prioritet Kombëtar/Sektorial
	Prioritet në procesin e anëtarësimit në BE
	E rëndësishme për donatorët
Përputhshmëria me SMP	Përputhshmëria me SMP
	Lejon krahasime me standardin

Korniza analitike dhe kategorizimi i të dhënave

Për të ofruar një pasqyrë të detajuar dhe krahasuese të çdo shërbimi, analiza përdor këto kategorizime:

1. Madhësia e Bashkisë sipas Popullsisë së Banuar:

- o deri në 10.000 banorë
- o 10.000 – 50.000
- o 50.000 – 150.000
- o Tiranë

BANORË	NR	BASHKITË	NGJYRA
0-10'000	15	Përmet, Dropull, Tepelenë, Pukë, Memaliaj, Pustec, Kolonjë, Selenicë, Himarë, Fushë Arrëz, Delvinë, Këlcyrë, Konispol, Libohovë, Poliçan	
10'000-50'000	33	Mirditë, Gjirokastrë, Kukës, Skrapar, Devoll, Finiq, Mat, Pogradec, Klos, Roskovec, Cërrik, Belsh, Peqin, Tropojë, Maliq, Kavajë, Librazhd, Gramsh, Vau Dejës, Divjakë, Shijak, Mallakastër, Prrenjas, Has, Kuçovë, Malësi e Madhe, Kurbin, Rrogozhinë, Sarandë, Bulqizë, Dimal, Patos, Vorë	
50'000-150'000	12	Berat, Shkodër, Korçë, Lezhë, Elbasan, Fier, Kamëz, Dibër, Lushnjë, Vlorë, Durrës, Krujë	
>150'000	1	Tiranë	



2. **Dendësia e Bizneseve², e klasifikuar si raporti i bizneseve ndaj popullsisë:**
 - E ulët
 - Mesatare
 - E lartë
3. **Lloji i Kompozitës së Tokës³, e klasifikuar sipas sipërfaqes bujqësore/pyjore në raport me sipërfaqen totale:**
 - Kryesisht bujqësore
 - Kombinim bujqësor dhe pyjor
 - Kryesisht pyjore

ECURIA E PROCESIT

1. Kuadri institucional dhe bazë ligjore

Në mbështetje të Urdhrit të Kryeministrit nr.17, datë 20.02.2023, për krijimin e grupit ndërinstitutional të punës, u hodhën hapat e parë për hartimin e propozimeve ligjore me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes Sistemit të Matjes së Performancës (SMP). Grupi Ndërinstitutional i Punës (GNP) i udhëhequr nga MSHPV përbëhet nga anëtarë të 9 ministrive përkatëse. Në vijim, vepron edhe grupi Teknik i Punës, i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AMVV-së, i cili përbëhet nga 11 anëtarë të ministrive përkatëse, 6 anëtarë të institucione të qeverisë qendrore dhe 2 anëtarë të shoqatave të qeverisjes vendore.

Fillimisht, procesi nisi me zhvillimin e tre takimeve rajonale në dhjetor 2024, ku u morën mendimet dhe sugjerimet nga ana e përfaqësuesve të bashkive për përmirësimin e treguesve. Gjatë këtyre takimeve, u prezantua për herë të parë edhe iniciativa e MSHPV për krijimin e mekanizmit të Grantit të Bazuar në Performancë.

Puna vijoi me diskutimin e treguesve ekzistues dhe vështirësitë e problemet e hasura gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave SMP 2023, të cilat duhet të merreshin në konsideratë për sistemin e ri të matjes së performancës. AMVV së bashku me asistencën teknike të projektit BtF bashkëpunuan për krijimin e listës së treguesve **të rinj** dhe atyre ekzistues të përmirësuar.

Pas vlerësimit të parë gjatë periudhës janar – mars 2025, u mbajtën një sërë takimesh konsultuese me Grupin Teknik të Punës, për diskutimin e propozimeve finale të treguesve, me

² Kategorizimi në "të ulët", "të mesëm" dhe "të lartë" është bërë duke përdorur si pikë ndarëse devijimin nga devijimi standard i raportit të bizneseve për banorë. "Të ulët" i referohet atyre bashkive që kanë më pak se 40 biznese për 1,000 banorë, "të mesëm" = 30 - 70 biznese për 1,000 banorë, dhe "të lartë" i referohet atyre bashkive që kanë një përqendrim prej më shumë se 80 biznesesh për 1,000 banorë.

³ Bashkitë janë kategorizuar sipas llojit dominues të përbërjes së tokës duke përdorur metodologjinë e mëposhtme: ato në të cilat toka bujqësore përbën mbi 50% të sipërfaqes totale klasifikohen si kryesisht bujqësore. Ndërsa, ato ku më shumë se 50% e territorit nga pyje dhe kullota konsiderohen kryesisht të pyllëzuara. Të gjitha bashkitë e tjera, që nuk përmbushin asnjë kriter, kategorizohen si me përbërje të përzier midis tokës bujqësore dhe pyllit.



qëllim miratimin nga GNP. Në këto takime konsultuese morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe organizata jo qeveritare për secilën fushë: MA, MSHRF, SHKBSH, INSTAT, UNICEF, UN Women, MBZHR, AKM, MTM, AKPT, AKEM, KE, BtF, IOM, GIZ, MSHMS, SHSSH, MAPA, PQH, IDP, IDM si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në qershor GNP ka miratuar treguesit e SMP 2024, të cilët janë ndërtuar mbi **tre kategori themelore**: menaxhimi financiar, shërbimet dhe mirëqeverisja të detajuara në **52 tregues të performancës**.

2. Dokumentet udhëzuese dhe metodologjike

Për sigurimin e cilësisë së të dhënave janë përgatitur një paketë dokumentesh udhëzuese dhe metodologjike për të mbështetur bashkitë në raportim të SMP-së. Këto përfshijnë:

- **Manualin për sigurimin e cilësisë së të dhënave**, i cili përshkruan parimet e raportimit, metodat e përlogaritjes dhe procedurat e verifikimit
- **Pasaportat e treguesve të performancës**, të cilat specifikojnë formulat e llogaritjes, burimet e të dhënave dhe frekuencën e raportimit;
- **Pyetësor i SMP** në excel sipas fushave me të dhëna për t'u mbledhur dhe verifikuar nga Kordinatori i Performancës;
- **Pyetësor i SMP** në google form i cili shërbeu për mbledhjen e të dhënave të unifikuara në një databazë me 61 bashkitë.
- **Dokumentacion mbështetës për sektorët** (arsim, ujitje, pyje dhe kullota, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet sociale, transparenca, etj.).

Qëllimi i këtyre dokumenteve ishte sigurimi i një procesi të unifikuar, krahasues dhe të besueshëm ndërmjet bashkive, duke rritur kapacitetin e tyre për raportim të saktë dhe të qëndrueshëm.

3. Trajnimet dhe fuqizimi i kapaciteteve

Procesi vijoi me një seri trajnimesh kombëtare dhe rajonale, të organizuara nga AMVV me mbështetjen e projektit *Bashki të Forta*. U aplikua qasja “kaskadë”, ku fillimisht u trajnuan trajnerët kryesorë (ToT), të cilët më pas zhvilluan trajnime me përfaqësues nga të gjitha fushat sektoriale në nivel vendor. Kjo skemë rezultoi e sukseshme dhe efikase për rritjen e kapaciteteve të Njërive të Performancës të NJVV-ve.

Janë kryer **5 trajnime rajonale** për të gjitha Bashkitë e vendit, nga ku morën pjesë Njësitë e Performancës ose stafi i specializuar në fusha përkatëse në bashki.

Kjo strategji trajnimi e hartuar sipas skemës:

- 1 trajner kryesor + 1 asistent trajner mundësuar nga **AMVV**;
- Përfaqësues dhe ekspert të mundësuar nga projekti *Bashki të Forta*;

Këto trajnime kishin për qëllim:

- rritjen e kapaciteteve teknike të koordinatorëve të performancës;

- njohjen me manualin e SMP-së dhe pasaportat e treguesve ku u prezantuan në detaje metoda e llogaritjes së treguesit, mbledhjes dhe verifikimit të tij;
- Pyetësi i shpjeguar dhe në formatin google form duke realizuar një shembull praktik;
- Udhëzime mbi respektimin e kushteve logjike të të dhënave për një raportim të saktë.


4. Asistenca dhe monitorimi në terren

Pas fazës së trajnimeve, AMVV zbatoi një plan shërbimesh në terren për mbështetje teknike dhe monitorim të procesit për qarqet e vendit (Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë) mbi:

- Përdorimin e manualit dhe pyetësorëve elektronikë (Google Forms, Excel);
- Verifikimin e plotësisë së pyetësorëve;
- Krahasimin ndërmjet raportimeve elektronike dhe dokumentacionit fizik;
- Sqarimin e paqartësive teknike dhe asistencë mbi afatet e raportimit.

Këto takime janë organizuar mbi një kalendar takim/trajnimesh pasi për **bashkitë të cilat e patën të pamundur të ndiqnin trajnimin** në asnjë prej ditëve, stafi i AMVV ofroi mundësinë e zhvillimit të trajnimeve pranë ambienteve të bashkisë. Theksojmë se të 61 bashkitë e kanë marrë trajnimin e nevojshëm për raportimin e të dhënave SMP. Nga 61 bashkitë e **vendit 332 staf bashkiak** kanë marrë pjesë në trajnime mbi SMP 2024, nga **262 staf i përcaktuar** nga bashkia me shkresë si pjesë e Njesisë së Performancës. Ky numër i shtuar ka ardhur si rezultat i rëndësisë që bashkia i ka kushtuar këtij procesi, si dhe për shkak të natyrës tepër teknike të tij, e cila ka kërkuar përfshirjen edhe të stafit nga drejtoritë përgjegjëse për raportimin e të dhënave përveç stafit të NJP. Të gjitha bashkitë e vendit kanë qenë pjesëmarrëse me të paktën 1 staf në trajnimet e zhvilluara.

Zhvillimi i trajnimeve rajonale



Krahas asistencës së ofruar për verifikim të të dhënave, stafi organizoi gjithashtu dhe trajnim ose informim lidhur me **Grantin bazuar në performancë** ku janë specifikuar kriteret e alikimit për çdo tregues të tij si dhe mënyrën e aplikimit. Gjatë kësaj periudhe bashkitë janë informuar për **Udhëzimin e Përbashkët Nr.1, Datë 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025”** për të cilën bashkitë kishin vijuar punën për përmbushjen e treguesve (hartimi i planeve vendore).



5. Lidhja e SMP-së me Grantin e Performancës

Sistemi i Matjes së Performancës është i lidhur ngushtë me mekanizmin e Grantit të Performancës (GBP). SMP siguron bazën e të dhënave dhe mekanizmin e verifikimit mbi të cilin mbështetet ndarja e fondeve. Raportimi i plotë dhe cilësor në kuadër të SMP-së përbën një nga kriteret të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët të MF dhe MSHPV, duke e bërë atë një instrument që jo vetëm mat performancën, por edhe stimulon përmirësimin e saj përmes mbështetjes financiare.

6. Komunikimi me bashkitë

AMVV ka vijuar komunikimin në mënyrë të vazhdueshme me bashkitë, si në formë shkresore zyrtare, ashtu edhe me komunikime të drejtpërdrejta me koordinatorët e performancës. Përmes këtyre njoftimeve, janë përcjellë udhëzimet, afatet dhe dokumentacionet e nevojshme, duke theksuar në çdo rast lidhjen mes raportimit në SMP dhe përfitimit nga Granti i Performancës. Kjo qasje ka garantuar qartësi procedurale dhe ka rritur ndërgjegjësimin e bashkive mbi rëndësinë e raportimit cilësor dhe në kohë.

7. Raportimi i bashkive

Në mbështetje të Udhëzimit të Përbashkët nr.1, datë 11.07.2025, bashkitë kanë kryer raportimin pranë AMVV në përputhje me kërkesat e përcaktuara në të. Raportimi është realizuar si nëpërmjet platformës elektronike **Google Form**, ashtu edhe në formë shkresore zyrtare, duke siguruar dorëzimin e të dhënave të nevojshme për treguesit e SMP. Të gjitha raportimet janë përmbyllur brenda afatit të përcaktuar, datë **31 korrik 2025**, në përputhje me parashikimet e udhëzimit dhe në respektim të procedurave të miratuara për verifikimin e cilësisë dhe plotësisë e dokumentacionit.

MENAXHIMI FINANSIAR





Menaxhimi Financiar, 2024

Përmes vlerësimit të treguesve të performancës financiare, ky raport synon të evidentojë mënyrën se si cilësia e menaxhimit financiar të bashkive reflektohet në aftësinë e tyre për të arritur standardet e shërbimeve publike. Menaxhimi i financave vendore nuk kufizohet vetëm në mbledhjen e të ardhurave apo ekzekutimin e buxhetit, ai lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin e çdo bashkie për të planifikuar, priorizuar dhe përdorur burimet në mënyrë efikase, transparente dhe të qëndrueshme.

Për të vlerësuar këtë aspekt në mënyrë gjithëpërfshirëse, raporti përdor një kuadër treguesish që mat performancën financiare nga disa dimensione të ndërlidhura. Kombinimi i këtyre treguesve ofron një pasqyrë të plotë mbi mënyrën se si pushteti vendor menaxhon financat publike dhe se sa efektiv është ky menaxhim në mbështetjen e funksioneve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Kjo qasje e bazuar në evidenca u mundëson bashkive, institucioneve qendrore dhe aktorëve të zhvillimit të identifikojnë modelet pozitive të menaxhimit financiar, të evidentojnë sfidat strukturore dhe të ndërmarrin masa të synuara për forcimin e autonomisë.

Realizimi i buxhetit dhe përdorimi i të ardhurave

Për vlerësimin e performancës financiare në 61 bashki për vitin 2024, sipas metodologjisë së miratuar nga GNP u përfshinë 11 tregues financiarë të kategorizuar në të ardhura dhe shpenzime. Treguesit kryesorë përfshijnë:

- i) buxheti për frymë;
- ii) të ardhurat e veta për frymë;
- iii) investime për frymë; dhe
- iv) përqindja e realizimit të buxhetit.


Viti 2024 për pushtetin vendor në Shqipëri paraqiti një tablo të ndërlikuar, ku kapacitetet financiare, struktura demografike dhe dinamika ekonomike e territorit ndikuan në performancën e bashkive.

Analiza tregon se bashkitë më të vogla marrin buxhet më të lartë për frymë, bashkitë më të mëdha me një përqendrim më të lartë biznesesh gjenerojnë më shumë të ardhura nga burimet e veta.

Kombinimi i treguesve financiarë ofron një panoramë të balancuar midis resurseve të disponueshme dhe aftësisë për t'i përdorur ato. Ai ndihmon në identifikimin e bashkive që vuajnë nga mungesa e kapaciteteve fiskale, bashkive që arrijnë të shfrytëzojnë mirë potencialin ekonomik, si dhe atyre që përballen me kufizime të dukshme në menaxhimin e buxhetit dhe në orientimin e fondeve drejt investimeve që krijojnë vlerë të qëndrueshme për komunitetin.



GRAFIKU 5: BUXHETI, TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET, 2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV


Nga grafiku i mësipërm, bashkitë e vogla (deri në 10,000 banorë) kanë buxhetin më të lartë për frymë (46,438 lekë) dhe realizojnë investime relativisht të larta. Kjo krijon një paradoks klasik të qeverisjes vendore ku sa më i vogël territori, aq më i madh financimi për çdo banor. Kjo nuk vjen si rezultat i performancës, por i shpërndarjes së fondeve ku bashkitë e vogla përfitojnë më shumë nga transfertat qendrore, të cilat nuk korrespondojnë me kapacitetet reale zhvillimore. Ky mekanizëm i shërbim qartë objektivit për ruajtjen e standardeve të shërbimeve në të gjithë territorin pavarësisht numrit të popullsisë.

Tirana dhe bashkitë me densitet të lartë biznesesh gjenerojnë të ardhura të larta për frymë (16,680 – 28,752 lekë), kjo tregon dy dimensione të rëndësishme të performancës:

- **Kapacitet administrativ** që kushtojnë më shumë kontroll fiskal, administrojnë më mirë taksat dhe tarifat dhe ka më shumë staf të specializuar.
- **Baza ekonomike e territorit**, aty ku ka më shumë biznese, ka më shumë mundësi për të ardhura vendore.

Në kontrast, bashkitë me densitet të ulët biznesesh dhe ato të vogla mbeten strukturalisht të varura dhe nuk arrijnë të gjenerojnë ekonomi lokale funksionale. Kjo nënkupton se aftësia për të krijuar të ardhura është një masë e drejtpërdrejtë e pjekurisë së qeverisjes vendore.

GRAFIKU 6: BUXHETI PËR FRYMË DHE REALIZIMI I BUXHETIT FAKT VS PLAN 2023-2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV




Krahasuar me një vit më parë, pushteti vendor, ka rritur jo vetëm buxhetin për frymë por edhe realizimin e buxhetit krahasuar me planin e parashikuar. Në vitin 2024, u realizuan 31,213 lekë për frymë ose 2,765 lekë për frymë më shumë se një vit më parë. Rritja prej 9.7% e shpenzimeve për frymë është tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së financimit të shërbimeve vendore.

Kategoria e treguesve të të ardhurave të bashkive përbëhet nga tre tregues:

- i) Të ardhurat e veta për frymë;
- ii) Autonomia vendore (Të ardhurat e veta vs. Transfertave në %); dhe
- iii) Shkalla e përdorimit të të ardhurave (Të ardhurat totale vjetore kundrejt shpenzimeve faktike).

Të ardhurat e veta përfaqësojnë një pjesë të vogël të burimeve financiare për pjesën më të madhe të bashkive, ndërkohë që mesatarja kombëtare është pak më shumë se gjysma e burimeve totale të buxhetit (53%). Ky tregues i cili shpreh autonominë financiare të pushtetit vendor, i analizuar sipas kategorive të popullsisë është një tablo e qartë e performancës së pushtetit vendor në kontekstin e menaxhimit financiar. Në tabelën e mëposhtme në formë matrice janë analizuar të ardhurat e veta të pushtetit vendor krahasuar me numrin e banorëve dhe buxhetin që ato kanë në dispozicion.

GRAFIKU 7: TREGUESIT E TË ARDHURAVE TË BASHKISË, 2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Të dhënat e paraqitura në grafik tregojnë se performanca e bashkive shqiptare në vitin 2024 është thellësisht e ndikuar nga aftësia e tyre për të gjeneruar të ardhura të veta, e cila është një nga treguesit më të rëndësishëm të autonomisë vendore.

Faktorët ekonomikë si madhësia e popullsisë dhe përqendrimi i bizneseve luajnë një rol të rëndësishëm në mirë-menaxhimin financiar të NJVV-ve në Shqipëri. Bashkitë me potencial turistik, janë gjithashtu të favorizuara për të ardhura të veta nga disa burime që lidhen me rritjen e aktivitetit ekonomik.


Bashkitë e vogla, me deri në 10,000 banorë, sigurojnë vetëm 10,367 lekë të ardhura për frymë dhe pesha e tyre në buxhet nuk i kalon 18%, duke treguar varësi të fortë nga transfertat



qendrore. Ndërkohë, bashkitë më të mëdha arrijnë të gjenerojnë më shumë të ardhura për frymë, por vetëm Tirana shfaq një autonomi të qartë fiskale me 43,069 lekë për frymë dhe një peshë të të ardhurave të veta që arrin në 83%.

Këto tregues të kombinuar zbulojnë një performancë të ndryshme strukturalisht të qeverisjes vendore në vend. Ndërsa bashkitë me ekonomi aktive dhe popullsi urbane shfaqin kapacitete të larta për të gjeneruar të ardhura dhe për të financuar shërbime publike, shumica e bashkive të vogla dhe atyre me densitet të ulët biznesesh mbeten lehtësisht të prekshme nga kufizimet fiskale dhe varësia nga qeveria qendrore.

GRAFIKU 8: TË ARDHURAT E VETA PËR FRYMË DHE NË BUXHET 2023-2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Pushteti vendor në vitin 2024 ka rritur ndjeshëm të ardhurat nga burimet e veta për frymë krahasuar me një vit më parë. Më një rritje prej 27.3% ose 3 967 lekë më shumë në vitin 2024, bashkitë kanë jo vetëm mundësi më shumë për të investuar në shërbimet publike por paraqesin dhe mirëadministrimin e burimeve në dispozicion.

Kategoria e treguesve të shpenzimeve dhe investimeve të bashkive përbëhet nga katër tregues të zgjedhur që synojnë të nxjerrin në pah performancën e përdorimit të burimeve në dispozicion, si:


- i) Shkalla e përdorimit të të ardhurave;
- ii) Realizimi i buxhetit;
- iii) Investime për frymë;
- iv) Pesha e investimeve në buxhetin vendor

Grafiku i mëposhtëm për vitin 2024 tregon një kontrast të theksuar mes shkallës së përdorimit të të ardhurave (sa nga të ardhurat potenciale në dispozicion përkthehen në shpenzime faktike) dhe realizimit faktik të buxhetit, duke pasqyruar sfidat strukturore të pushtetit vendor në Shqipëri. Ndërkohë që disa bashki kanë vështirësi ti kthejnë të ardhurat në dispozicion (kryesisht bashkitë e mëdha) në shpenzime publike, ka bashki të tjera që janë efektive dhe me presion të shtuar për burime të nevojshme financimi. Kjo tregon jo vetëm presionin e lartë në



rritje për shërbime publike por gjithashtu edhe nevojën që vazhdimisht ky financim të rritet si pasojë e rritjes së kostove.

GRAFIKU 9: PËRDORIMI I TË ARDHURAVE DHE BUXHETIT, 2024




Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Bashkitë me densitet të lartë biznesesh, përfshirë edhe Tiranën, të cilat kanë burime më të mëdha në dispozicion, shfaqin nivele të larta përdorimi të të ardhurave, duke përfituar nga baza më solide ekonomike e rajonit dhe nga aftësia për të mobilizuar burime shtesë.

Kur analizohet realizimi i buxhetit, ecuria ndryshon për një pjesë të bashkive, sidomos në ato që realizojnë më pak se 70% të buxheteve të planifikuara. Këto bashki reflektojnë pengesa në kapacitetet administrative, procedura të gjata prokurimi dhe shpesh herë mungesë ekspertize teknike si rrjedhim i lëvizjes së popullsisë. Kjo është një tendencë e njohur në qeverisjen vendore, ku planifikimi shpesh është ambicioz, por realizimi i investimeve ngec për shkak të kufizimeve institucionale dhe menaxheriale. Në vitin 2024, ky hendek mes pritshmërive dhe rezultateve tregon se sfida kryesore e pushtetit vendor mbetet aftësia për të kthyer burimet në shërbime, infrastrukturë dhe zhvillim real për komunitetin.

GRAFIKU 10: SHKALLA E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE DHE NDAJ BUXHETIT 2023-2024




Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV



Të dhënat e investimeve për frymë tregojnë qartë se aftësia investuese e bashkive në vitin 2024 mbetet e kushtëzuar nga madhësia e territorit, kapacitetet administrative dhe dinamika ekonomike lokale.


GRAFIKU 11: INVESTIMET, 2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Ky grup treguesish ofron një pasqyrë të burimeve dhe dinamikës së investimeve në bashkitë e Shqipërisë, të kategorizuara sipas madhësisë dhe densitetit të bizneseve. Investimet në infrastrukturë mbeten të rëndësishme për qeverisjen vendore, me rezultate që tregojnë se bashkitë më të vogla kanë tendencën të investojnë më shumë për frymë.

GRAFIKU 12: INVESTIME PËR FRYMË 2023-2024



Duke i analizuar për frymë investimet vendore në vite kanë patur një rënie të lehtë. Në vitin 2024 investimet për frymë ishin 6,376 lekë, ose rreth 5.2% më pak se në vitin 2023. Rënia e investimeve për frymë është shoqëruar me rritjen e investimeve korrente.

Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Bashkitë e vogla, me deri në 10,000 banorë, kryejnë investime relativisht të larta për frymë (6,970 lekë), ndërsa bashkitë me popullsi mesatare tregojnë vlera më të ulëta, duke zbritur deri në rreth 5,298 lekë investime për frymë në popullsitë e mëdha. Tirana qëndron dukshëm mbi mesataren me 8,960 lekë investime për frymë. Edhe sipas densitetit të bizneseve, vërehet se bashkitë me ekonomi më të mirë arrijnë të investojnë më shumë, ato me densitet të lartë biznesesh shfaqin 7,128 lekë investime për frymë, një tregues se zhvillimi ekonomik lokal rrit jo vetëm të ardhurat, por edhe aftësinë për të rikthyer vlerë në komunitet në formën e projekteve publike.



Në aspektin e peshës së investimeve në buxhet, të dhënat sugjerojnë një tjetër dimension të performancës. Mesatarja kombëtare prej 20% tregon se investimet zënë një pjesë të kufizuar të buxheteve vendore, duke reflektuar orientimin ende të lartë drejt shpenzimeve korrente. Bashkitë e vogla dhe ato me densitet të ulët biznesesh arrijnë peshë relativisht më të lartë investimi (15-20%), ndërsa bashkitë me densitet të mesëm biznesesh shfaqin përqindjen më të ulët (16%), duke treguar një menaxhim më konservativ ose kapacitete më të dobëta në planifikimin e projekteve. Pesha e investimeve në bashkitë me ekonomi të fortë mbetet e moderuar (18%), çka tregon se edhe pse ato investojnë më shumë në total dhe për frymë, pjesa më e madhe e buxhetit shkon për të përballuar kërkesat e larta të shërbimeve publike urbane. Ky kombinim treguesish nënvizon se performanca e bashkive në fushën e investimeve varet jo vetëm nga disponueshmëria e fondeve, por nga aftësia për t'i strukturuar, planifikuar dhe ekzekutuar ato në një mjedis kompleks financiar dhe administrativ.

GRAFIKU 13: PESHA E SHPENZIMEVE TE PERSONELIT, OPERATIVE DHE INVESTIME NË BUXHET 2023-2024



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritje nga AMVV

Trendi i dy viteve të fundit tregon një zhvendosje të dukshme në strukturën e shpenzimeve të pushtetit vendor, që sinjalizon rritje të kostove të brendshme operacionale në kurriz të hapësirës për investime. Si shpenzimet e personelit (nga 43% në 45%), ashtu edhe ato operative (nga 33% në 35%) janë rritur ndjeshëm, duke dëshmuar se bashkitë po përballen me presione më të larta financiare për të mbuluar shërbimet bazë dhe funksionimin e administratës. Kjo rritje e dyfishtë tregon një strukturë buxhetore që po bëhet më pak fleksibël, ku totali i burimeve të përthithura nga nevojat e brendshme po zgjerohet dhe po kufizon aftësinë e pushtetit vendor për të orientuar fondet drejt zhvillimit afatgjatë.

Ndërkohë, ulja e peshës së shpenzimeve kapitale nga 24% në 20% tregon qartë se hapësira për investime po ngushtohet. Ky fenomen, në kontekstin e performancës së pushtetit vendor, shpesh interpretohet si një sinjal dobësimi i kapaciteteve për të gjeneruar projekte zhvillimore, për të mirëmbajtur infrastrukturën, apo për të ngritur cilësinë e shërbimeve publike. Përtej një lëvizjeje teknike në përqindje, trendi është një kujtesë e drejtpërdrejtë se pa rritje të të ardhurave vendore ose pa menaxhim më të rreptë të shpenzimeve të brendshme, investimet rrezikojnë të bëhen elementi i parë që sakrifikohet duke ndikuar negativisht në performancën e përgjithshme dhe në perceptimin e qytetarëve për efektivitetin e qeverisjes vendore.

SHËRBIME



Shërbimet, 2024

Arsimi


Arsimi parashkollor shënon një dekadë nga transferimi i plotë i tij nga Ministria e Arsimit pranë bashkive. Në këtë dekadë, bashkitë i janë dedikuar më së shumti mirëmbajtjes dhe administrimit të ndërtesave për arsimin parauniversitar, si dhe administrimin e arsimit të hershëm publik në kopshte dhe çerdhe. Ndërkohë që ndërtimi dhe rehabilitimi janë kryesisht aktivitete që bashkitë i kanë kryer me mbështetjen e programeve të dedikuara të qeverisjes qendrore apo donatorëve.

Ecuria dhe performanca e shërbimit arsimor në Shqipëri u vlerësua duke përdorur pesë tregues kryesorë nga të cilët dy janë të rinj dhe tre janë përdorur edhe për vlerësimin e performancës së bashkive për vitin 2023:

- i) shkalla e regjistrimit në çerdhe (publike),
- ii) shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private (me të dhëna të disagreguara publike – private);
- iii) raporti fëmijë-mësues;
- iv) numri i infrastrukturës arsimore parauniversitare sipas nivelit arsimor
- v) plani vendor i arsimit parauniversitar.

Cilësojmë se treguesi që lidhet me infrastrukturën zëvendëson treguesin e përdor në Raportin e vitit 2023 për këtë fushë pasi u vërejtën problematika në lidhje me matjen e saktë të tij (shkalla e mirëmbajtjes së objekteve shkollore në arsimin parauniversitar). Treguesi i planit vendor është një tregues i ri i SMP që lidhet me Grantin e Performancës së Bashkive.

GRAFIKU 14: INDIKATORI I ARSIMIT PARASHKOLLOR, 2024




*Mesatarja e Marxhinalizuar nuk përfshinë bashkitë që nuk kanë çerdhe dhe kopshte private

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Aksesi në arsimin e hershëm tregon se institucionet private kompensojnë mungesat që kanë bashkitë nga strukturat e tyre publike kryesisht në bashkitë e mëdha të vendit ku edhe kërkesa për këtë shërbim është më e lartë. Treguesit për çerdhet është matur vetëm për institucionet publike. Numri i fëmijëve të regjistruar në vitin 2024 për këtë shërbim është rritur me 26% krahasuar me vitin 2023, një trend rritës prej 2.6 pikë përqindje të shkallës së regjistrimit në çerdhe. Niveli mesatar kombëtar i regjistrimit në çerdhe mbetet i ulët edhe pse në rritje me

12.5% kundrejt një viti më parë, ndërkohë që Tirana ka dyfishuar ofrimin e këtij shërbimi me gati dy herë (nga 12.9% në vitin 2023 në 24.8% në vitin 2024). Edhe këtë vit 17 bashkitë e identifikuar gjatë vitit 2023, vazhdojnë të mos e ofrojnë shërbimin publik të çerdheve.

GRAFIKU 15: TRENDI I REGJISTRIMIT NË ÇERDHE, 2023-2024




Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private në vitin 2024 arriti në 68,6%, me një rënie të lehtë kundrejt vitit 2023. Ky nivel është larg atij të 27 vendeve të BE-së (për vitin 2023 ishte 90.6%) por i përafërt me vendet e rajonit (Serbi: 61.8%; Mali i Zi: 72.4%).

Bashkitë më të vogla tregojnë norma më të larta, duke arritur në disa prej tyre në vlera mbi 90% (Tepelena, Selenica, Rrogozhina). Norma e regjistrimit në bashkitë e mëdha është dukshëm më e ulët për shkak të mbulimit të këtij shërbimi nga sektori privat.

Edhe pse me shifra të përafërta me rajonin, shkalla e ulët e regjistrimit në arsimin e hershëm është rezultat edhe i lëvizjes së popullsisë dhe rënies së lindjeve.

GRAFIKU 16: TRENDI I REGJISTRIMIT NË KOPSHTË, 2023-2024




Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Raporti nxënës-mësues ndryshon ndjeshëm nga njëra bashki në tjetrën në varësi të madhësisë së saj si dhe në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Të dhënat tregojnë se mesatarja për Shqipërinë është afër mesatares së 27 vendeve të BE-së për vitin 2023 (12.2:1⁴), dhe pothuajse në të njëjtat nivele me vende si Hungari, Poloni, Qipro, Rumani, dhe brenda vlerave që kanë vendet e rajonit (Serbia: 10.8:1 dhe Mali i Zi: 16.6:1).

⁴EUROSTAT:https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/EDUC_UOE_PERP04/default/table?lang=en&utm_source=chatgpt.com

GRAFIKU 17: TRENDI I RAPORTIT FËMIJË – MËSUES NË KOPSHTË, 2023-2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Diferenca ndërmjet këtij raporti në kopshte publike dhe private është ngushtuar në vitin 2024 kundrejt një viti më parë duke arritur në një mesatare kombëtare respektivisht në 13.7:1 dhe 11.3:1. Gjithsesi këtu duhet cilësuar fakti që të dhënat janë mesatare për bashki ndërkohë që ky tregues mund të variojë nga njëra njësi administrative në tjetrën brenda së njëjtës bashki.

Bashkitë më të mëdha, si Tirana dhe ato me popullsi mbi 50.000 banorë, tregojnë raportet më të larta, përkatësisht 18.2 dhe 15.3 në kopshte publike, duke theksuar nevojën për burime të shtuara arsimore në këto zona.

Infrastruktura arsimore parauniversitare sipas nivelit arsimor konfirmon diferencën midis madhësive të bashkisë në lidhje me numrin e godinave që ato menaxhojnë (psh: Pusteci 8⁵; Tirana 520).

I matur për herë të parë për këtë raport ky tregues mund t'i ndihmojë bashkitë për të planifikuar më mirë investime në infrastrukturë dhe nxjerr në pah pabarazinë territoriale (urbane vs rurale), si rrjedhojë e lëvizjes së popullsisë nga zonat periferike në qendër dhe nga qytetet e vogla tek ato të mëdha.

Treguesi “Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar” në thelb, tregon nëse njësia vendore ka hartuar, miratuar dhe po zbaton një plan të integruar për arsimin parauniversitar, në përputhje me politikat kombëtare. Kjo është edhe arsyeja pse ky tregues është pjesë e Grantit të Performancës së Bashkive. Për vitin 2024 duket se vetëm 2 bashki kanë plane vendore të cilat janë Rrogozhina dhe Dimali, të dyja bashki të mesme. Vendosja e këtij treguesi pjesë e Grantit synon të nxisë bashkitë të hartojnë plane si parakusht për planifikimin më të mirë të këtij shërbimi.

Shërbimet sociale

Reforma Administrativo-Territoriale e transferoi tek bashkitë përgjegjësinë për të ofruar shërbime sociale për një numër të gjerë shtresash në nevojë. Shërbimi social është më i rëndësishmi për bashkinë dhe zë një peshë që luhet diku rreth 30 – 60% të buxhetit të bashkisë

⁵ Të dhënat e këtij treguesi duhen vlerësuar me kujdes pasi në një ndërtesë shpesh gjendet shërbimi i çerdhes dhe i kopshtit; dhe po ashtu i kopshtit dhe i shkollës dhe mund të jetë raportuar më shumë sesa një herë e njëjta godinë.



sipas madhësisë së saj. Bashkitë marrin transfertë të kushtëzuar nga qeveria për të mbështetur ofrimin e këtij shërbimi për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma monetare dhe në mallra, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Bashkitë përdorin edhe të ardhurat e tyre për të realizuar këto shërbime.

Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” Nr. 121/2016 përkufizon një listë të gjatë shërbimesh të kujdesit shoqëror të cilat kanë përfitues të kategorive të ndryshme..


Duke qenë një shërbim kompleks edhe ky raport ka përdorur një paketë të gjerë treguesish performance për të kapur sa më shumë aspekte të shërbimeve sociale si:

- i) Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike;
- ii) Shkalla e miratimit të strehimit social;
- iii) Numri i qendrave sociale komunitare për 10,000 banorë;
- iv) Numri i rasteve të trajtuara kundrejt rasteve të raportuara të dhunës në familje (sipas gjinisë, moshës dhe llojit të dhunës);
- v) Përqindja e personave me aftësi të kufizuara, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale
- vi) Plani Vendor Social.

HARTA E FAMILJEVE ME NDIHMË EKONOMIKE (NË %)

% e familjeve në ndihmë ekonomike

- ≥ 20
- 15-20
- 5-15
- < 5



Tre treguesit e parë janë përdorur edhe në raportin e performancës së vitit 2023, ndërsa tre treguesit e fundit janë të rinj, ku ai i planit vendor është pjesë e vlerësimit të Grantit të Performancës. Figura në vijim ilustron shpërndarjen dhe efikasitetin e shërbimeve sociale në Shqipëri, duke paraqitur një panoramë të ndikuar nga kushtet ekonomike të çdo rajoni.


Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV



Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike, vlerëson shkallën e mbulimit të bashkive me skemën e ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë. Në mbarë vendin, rreth 6% e familjeve përfitojnë ndihmë ekonomike, ku rreth 91% e familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike janë mbështetur nga aktorët shtetëror. Kjo normë e lartë e miratimit të kërkesave tregon kritere të qarta për aplikuesit, lehtësi të procedurave nga ana e punonjësve të bashkisë si edhe krijimin e databazave historike në lidhje me aplikantët⁶.


Edhe këtë vit bashkitë e mesme dhe ato me densitet të ulët ekonomik kanë varësinë më të lartë nga ndihma ekonomike. Rajoni lindor i Shqipërisë (zonat e kuqe në hartë), i njohur për zhvillimin ekonomik të kufizuar, ka të paktën 13.5% të familjeve që përfitojnë ndihmë.

GRAFIKU 18: TREGUESIT E SHËRBIMIT SOCIAL, 2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

GRAFIKU 19: TRENDI I TREGUESVE TË SHËRBIMIT SOCIAL



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

⁶ Norma e lartë e përfituesve kundrejt aplikuesve teorikisht tregon se ka filtra jo të fortë vlerësimi. Ky mund të jetë rasti i bashkisë Tiranë e cila ka numrin më të lartë të aplikimeve si edhe normën më të lartë të miratimit të tyre.



Strehimi social shënon rritje, duke qenë se bashkitë kanë vënë në dispozicion banesa sociale nga viti në vit e për rrjedhojë edhe norma e miratimit të tyre kundrejt aplikimeve është rritur. Kryesisht kjo është më e lartë në bashkitë e mëdha të cilat kanë edhe buxhete më të mëdha për të ofruar strehim social.

Numri i qendrave sociale komunitare për 10,000 banorë, tregon numrin e qendrave rezidenciale komunitare publike që funksionojnë gjatë vitit raportues dhe ofrojnë strehim të përhershëm ose të përkohshëm dhe përkujdesje të plotë 24-orëshe për persona në nevojë, raportuar për 10,000 banorë. Ato mund të përfshijnë: shtëpi për fëmijë pa përkujdesje prindërore, shtëpi për të moshuar pa përkrahje, streha (emergjente apo afatgjata) për gra dhe vajza viktime të dhunës dhe trafikimit, shërbime rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara. Performancë më të mirë kanë bashkitë që janë mbështetur nga organizata jofitimprurëse të financuara nga donatorë si UNICEF; UNDP etj. Aktualisht bashkitë janë duke ngritur Fondin Social Vendor pikërisht për të zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet sociale vendore. Për 5 vite rresht fondi social është mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MShMS) me transferta në rritje nga viti në vit.

Përqindja e personave me aftësi të kufizuara, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale, tregon numrin e personave me aftësi të kufizuara që janë vlerësuar nga komisionet bio-psiko-sociale dhe janë referuar zyrtarisht për përfitim nga një ose më shumë shërbime sociale në territorin e bashkisë. Të dhënat nxjerrin në pah se mesatarisht në të gjithë vendin për vitin 2024 vetëm 30% e rasteve të referuara janë trajtuar, një normë shumë e ulët kjo. Duhet pasur parasysh se trajtimi i personave PAK është një shërbim kompleks dhe i kushtueshëm. Bashkitë e mëdha dhe ato me densitet të mesëm dhe të lartë të biznesit japin më shumë zgjidhje, duke i trajtuar rastet jo vetëm nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe qendrave funksionale për shërbime sociale por edhe komunitetit të biznesit dhe organizatave jofitimprurëse.

Bashkitë kanë detyrimin ligjor të caktojnë Koordinatorin Vendor të Dhunës (për çdo 200 mijë banor një koordinator). Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (MKR) që përfitojnë shërbime sociale tregon numrin e rasteve të trajtuara kundrejt rasteve të raportuara të dhunës në familje, është një tregues i ri i matur. Të dhënat nxjerrin në pah se mesatarisht në të gjithë vendin për vitin 2024, 87% e rasteve që janë referuar janë trajtuar një normë kjo e lartë po të kemi parasysh se ky është një shërbim delikat. Duket se bashkitë e mëdha dhe ato me densitet të mesëm dhe të lartë të biznesit i japin më shumë zgjidhje këtyre rasteve dhe koordinatori vendor i dhunës rezulton të jetë një mekanizëm i suksesshëm.

Që prej vitit 2018 bashkitë kanë përgjegjësinë (Ligji 121/2016 dhe VKM 378/2018) të hartojnë Plan Vendor Social, i cili është një tregues që vlerëson ekzistencën dhe zbatimin e Planit Social Vendor si dokument strategjik për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Ky dokument duhet të përfshijë edhe perspektivën gjinore të integruar. Ky tregues është bërë pjesë e Grantit bazuar në Performancë. Për vitin 2024 numërohen 45 bashki me plan, rreth 26% e bashkive nuk e kanë ende një dokument të tillë planifikimi i cili duhet të azhurnohet cdo tre vite dhe të drejtojë buxhetimin e shërbimeve sociale prioritare që ofron bashkia për komunitetin.

Menaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve është një shërbim tradicional i bashkive, ligji 139/2015, qartësoi këtë funksion duke detajuar gjithë gamën e aktiviteteve që ofron bashkia në realizimin e këtij shërbimi.


Vlerësimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve nga ana e bashkisë, bazohet në pesë tregues:

- i) mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (i disagreguar më vete për popullsinë urbane dhe atë rurale),
- ii) mbulimi i kostos nga tarifa e shërbimit,
- iii) mbetjet e gjeneruar për frymë;
- iv) kosto e 1 tonë mbetje në lekë si edhe
- v) ekzistenca e planit vendor të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve.

Treguesi i planeve është pjesë e Grantit bazuar në Performancë. Të gjithë këta tregues janë përdorur edhe në raportin e performancës të vitit 2023, përveç atij të planit vendor. Cilësojmë se treguesi i mbulimit të popullsisë me shërbim në zonat urbane dhe rurale është përmirësuar në matjen e tij për vitin 2024 krahasuar me 2023.

Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale mat përqindjen e popullsisë në bashki që mbulohet me shërbimin e mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve. Për llogaritjen e treguesit janë mbledhur të dhëna në nivel njësisht administrative dhe fshatrash ku ofrohet ky shërbim.

GRAFIKU 20: TREGUESIT E LIDHUR ME MENAXHIMIN E MBETJEVE, 2024




Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV



Pothuajse të gjitha bashkitë, pavarësisht madhësisë së tyre mbulojnë gati gjithë popullsinë në zonën urbane me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Zona rurale mbetet ende me performancë mesatare, kryesisht në bashkitë e vogla por edhe në bashkinë Tiranë. Kategorizimi i bashkisë sipas densitetit nuk sjellë ndonjë rezultat të ndryshëm nga ai i madhësisë së bashkisë. Është interesant fakti se menaxhimi i shërbimit është më i mirë kur ofrohet me nënkontraktorë privat në zonat rurale. Në nivel kombëtar zona rurale mbulohet rreth 65% me shërbim.

Në vitin 2024, mbulimi i gjithë popullsisë mesatarisht në të gjitha bashkitë me shërbim arriti në 85.6%. Të dhënat e vitit 2023 tregojnë shifra të rritura pasi mbledhja e të dhënave ishte bazuar në deklarinimin e vetë bashkive pa pasur një disagregim të detajuar të zonave urbane dhe rurale. Dukshëm bashkitë kanë rritur mbulimin me shërbim në territoret e tyre duke pasur një rritje me rreth 22% kundrejt vitit 2016⁷.

GRAFIKU 21: MENAXHIMI I MBETJEVE, 2023-2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV


Në vitin 2024, mesatarisht u gjeneruan rreth 357 kg/frymë në vit me një rritje kjo prej 3% kundrejt sasisë së gjeneruar për frymë një vit më parë.

Normën më të lartë të gjenerimit e ka bashkia Tiranë me 431 kg/frymë në vit dhe më të ulët e kanë bashkitë e mesme me rreth 255 kg/frymë në vit. Norma e gjenerimit trefishohet në bashkitë me intensitet të lartë biznesesh kundrejt atyre me intensitet të ulët. Norma mesatare e gjenerimit të mbetjeve urbane në 27 vendet e BE-së për vitin 2022 ishte 513 kg/frymë në vit. Theksojmë se në këtë raport norma e gjenerimit për bashkitë e vendit është llogaritur si sasi e mbetjeve të menaxhuara nga bashkia kundrejt numrit total të popullsisë.

Në nivel kombëtar rezulton se 83% e kostove për menaxhimin e mbetjeve mbulohen nga tarifat e shërbimit.

⁷ Burimi i informacionit: Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035 dhe raporti INSTAT 2016

GRAFIKU 22: EFICIENCA E MENAXHIMIT TË SHËRBIMIT, 2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Përmirësimi i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve me 14.7 pikë përqindje në 2024, ka bërë që edhe kosto e një ton mbetje të ulët me rreth 2.5%. Në shkallë vendi menaxhimi i 1 ton mbetje kushtoi mesatarisht 8,600 lekë. Kjo për shkak të grumbullimit dhe transferimit të një sasive më të madhe mbetjesh, kryesisht në sezonin e verës që lidhet ngushtësisht me zhvillimin e turizmit. Sasia totale e mbetjeve të menaxhuara nga bashkia u rrit vetëm me 2% kundrejt vitit 2023 (gjithsej 855 mijë në vitin 2024 kundrejt 835 mijë tonë në vitin 2023).

Bashkitë më të vogla mbulojnë rreth gjysmën e kostos nga tarifa ndërkohë që një numër i konsiderueshëm bashkish si: Tirana; Bulqiza, Korça, Elbasani, Fieri, Klosi, Kukësi, Tropoja, Vlora dhe Vau-Dejës mbledhin më shumë të ardhura nga tarifa sesa shpenzojnë në total për këtë shërbim. Në këto kushte grumbullimi i tarifës rezulton se shkon jo vetëm për të përmirësuar shërbimin por për të financuar buxhetin e përgjithshëm të bashkisë.

Në fund të vitit 2024 numërohen 28 bashki (ose rreth 46% e bashkive) që ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve bazuar në plane vendore të miratura për këtë shërbim.

Bujqësia


Një dekadë më parë bashkitë morën përgjegjësinë e menaxhimit të sistemit ujitës-kullues transferuar me VKM nr. 1108/2015. Bashkitë trashëguan një sistem të amortizuar, gjë për të cilën edhe me mbështetjen e qeverisë e kanë përmirësuar falë investimeve dhe një pune serioze operative për t'a bërë atë funksional dhe për të nxitur prodhimin bujqësor.

Nisur nga sfida në matjen e saktë të treguesve⁸ për këtë sektor në raportimin e vitit 2024 ky raport vjen me dy tregues të përmirësuar kundrejt raportit të vitit 2023: **i)** tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi dhe **ii)** përqindja e kanaleve funksionale të ujitjes dhe kullimit⁹.

Të dyja sistemet kulluese dhe ujitëse kanë ende probleme pasi funksionaliteti nën 50–65% nuk është një nivel i cili mbështet një bujqësi të zhvilluar, sidomos në zona me rrezik thatësirash dhe bashkitë me profil bujqësor. Performanca më e mirë në bashkitë me relief pyjor rrjedh për shkak të një terreni malor – kodrinor që e bën më të lehtë dhe më ekonomik procesin e funksionimit të kanaleve.

Ujitja mbetet më sfiduese si shërbim, sepse kërkon më shumë ndërhyrje teknike, operim aktiv dhe kosto për mirëmbajtjen e sistemit duke llogaritur rritjen e sistemit të kanaleve tretësore dhe koordinimin e funksionimit të tyre nga bashkia.

GRAFIKU 23: TRENDI I SIPËRFAQES SË TOKËS BUJQËSORE MBULUAR ME SISTEM, 2023-2024



Përmirësimi i funksionalitetit të sistemit ujitës dhe kullues ka rritur sipërfaqen e tokës bujqësore e pajisur me ujitje dhe kullim me rreth 13.5% krahasuar me një vit më parë, e për rrjedhojë edhe e rritjes së volumit të produktit bujqësor. Eksporti i produkteve bujqësore¹⁰ është rritur me gati 19% në vitin 2024 duke konfirmuar ndikimin e drejtëpërdrejtë që ka ky shërbim në bujqësinë shqiptare.

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV


⁸ Për matjen e treguesve, janë përdorur të dhënat e raportuara nga vetë bashkitë. Analiza e gjeneruar mund të sjellë devijime nga rezultati i saktë, pasi vlera e kanaleve në kilometra e raportuar nga bashkitë, nuk përputhet me vlerën e kanaleve në kilometra, e marrë nga Ministria e Bujqësisë.

⁹ Të dhënat u mbledhën duke matur gjatësinë e kanaleve të pastruara, e shprehur në kilometra, në krahasim me gjatësinë totale të rrjetit

¹⁰ Burimi i informacionit: https://agriculture.ec.europa.eu/system/files/2023-05/agrifood-albania_en.pdf?utm_source=chatgpt.com



GRAFIKU 24: PERFORMANCA E BUJQËSISË SIPAS GRUPEVE TË BASHKIVE, 2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Rezultatet, e ilustruara në figurë, analizohen sipas madhësisë së bashkive dhe përbërjes së tokës. Vihet re se në të treja grupet ka bashki me performancë shumë të mirë (100% e rrjetit është funksional). Grupimi i bashkive të vogla kanë performancën më të ulët në sistemin e kullimit. Madhësia e bashkisë nuk ndikon shumë në performancën e këtij shërbimi, por duket se grupimi sipas llojit të tokës është i rëndësishëm në nivelin e performancës së bashkive¹¹.

Sipas kësaj kategorie, performancë më të ulët për ujitjen kanë bashkitë me relief mix bujqësor dhe pyjor, ndërkohë që performanca rritet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga bashki bujqësore për të arritur në performancën më të lartë në bashkitë pyjore.


Në lidhje me kullimin performancën më të lartë e shënojnë bashkitë kryesisht bujqësore, duke vijuar me rënie të normës nga bashkitë me relief miks bujqësore-pyjore dhe bashkitë kryesisht pyjore.

Sipas raportimeve nga bashkitë, në të gjithë territorin ekzistojnë rreth 19,935 kilometra linear kanale për ujitjen dhe 19,455 kilometra kanale për kullimin. Funksionimi i këtyre kanaleve është relativisht i kënaqshëm, me normë prej 45% për kanalet e ujitjes dhe 64% për ato të kullimit. Ndërkohë 54% e tokave bujqësore janë të pajisura me infrastrukturë ujitëse dhe kulluese.

Bashkitë duhet të hartojnë plane pune të detajuara për mirëmbajtjen e sistemit ujitës dhe kullues me objektiva të qarta vjetorë.

¹¹ Bashkitë janë kategorizuar sipas llojit kryesor të përbërjes së tokës duke përdorur metodologjinë në vijim: ato në të cilat toka bujqësore përbën mbi 50% të sipërfaqes totale klasifikohen si kryesisht bujqësore. Ndërsa, ato ku mbi 50% e territorit është e mbuluar me pyje dhe kullota konsiderohen si kryesisht të pyllëzuara. Të gjitha bashkitë e mbetura, që nuk përmbushin asnjë nga kriteret, kategorizohen si të kenë një përbërje të përzier të tokës bujqësore dhe të pyllit. Bazuar në këtë shpërndarje, kilometrat e kanaleve të ujitjes janë ndarë përafërsisht në mënyrë të barabartë mes tre grupeve, me secilin grup që përmban rreth një të tretën e rrjetit total të kanaleve të ujitjes.

■ Kryesisht pyje
■ Bujqësore & pyje
■ Kryesisht bujqësore




Inventarizimi dhe regjistrimi i aseteve nga ana e bashkisë duhet të jetë prioritet për ndarjen e qartë të përgjegjësi. Sistemi mund të funksionojë vetëm kur fermerët përfshihen në menaxhim (krijimi i operatorëve ose grupeve të përdoruesve të ujit / OPU) që legjislacioni specifik e lejon. Dhe së fundmi nxitja e marrëveshjeve ndërbashkiake është çelës në disa bashki ku burimet ujore mungojnë.

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Pyjet dhe kullotat

Performanca e këtij shërbimi është vlerësuar duke përdorur dy tregues: **i)** mbulimi me plane të mbarështimit të pyjeve¹², dhe **ii)** staf në dispozicion për shërbimin¹³. Këta tregues ndihmojnë në matjen e kapacitetit të bashkisë për të garantuar menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave dhe për të drejtuar investimet drejt zonave që kanë nevojë për mbështetje.

GRAFIKU 25: TREGUESIT E MENAXHIMIT TË PYJEVE SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE, 2024



*Mesatarja e Marxhinalizuar nuk përfshinë bashkitë pa plan mbarështimi


Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

¹² Llogaritur si raporti i sipërfaqeve me plane mbarështimi ndaj sipërfaqes totale të pyjeve dhe kullotave në menaxhim nga bashkia

¹³ Llogaritur si numri i punonjësve për 1.000 hektarë në dispozicion për ofrimin e këtij shërbimi

Mbulimi me plane të mbarështimit të pyjeve reflekton nivelin e planifikimit dhe angazhimit institucional në menaxhimin e qendrueshëm të burimeve natyrore. Rezulton se 26 bashki (43% e bashkive) kanë plane mbarështimi të pyjeve në 2024 nga të cilat disa prej tyre e mbulojnë gjithë fondin pyjor me plan, pjesa tjetër kanë plane të pjesshme që mbulojnë nga 5% deri në 94% e sipërfaqes pyjore. Edhe pse në nivele të ulëta, mbulimi me plane i fondit pyjor dhe kulloror është rritur gjatë vitit të fundit (2024) me 4 bashki të reja, të cilat kanë hartuar plane mbarështimi.


GRAFIKU 26: TRENDI I MBULIMIT ME PLANE MBARËSHTIMI, 2023-2024



Analiza thekson nevojën për përmirësimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për shkak të mungesës së planeve të mbarështimit në shumë bashki dhe nivelit të stafit nën mesataren e BE-së. Rezultatet e kësaj matjeje konfirmojnë që standardi i vendosur nga ligji është një standard i nevojshëm.

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

GRAFIKU 27: TRENDI I PUNONJËSVE PËR SIPËRFAQE PYJORE, 2023-2024



Ligji “Për pyjet” nr. 57/2020 u kërkon bashkive të ngrenë strukturën përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre, me personel me arsim profesional dhe të lartë pyjor. Numri i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor sipas kategorive: **a)** një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta; **b)** një specialist pyjesh për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulëta dhe shkurret.

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Treguesi punonjës për 1,000 ha pyje ndihmon në kuptimin e shkallës së përkushtimit institucional për administrimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve. Vlerat e këtij treguesi edhe për vitin 2024 sikurse në vitin 2023 ndjekin një tendencë të ngjashme me mesataren kombëtare, më pak se një punonjës për 1,000 hektarë.

Përpara transferimit të funksionit, Ministria e Linjës përgjegjëse për këtë funksion angazhonte 1.25 punonjës/1,000 ha pyje¹⁴.

¹⁴ Të dhënat janë marrë nga PBA 2015-2018 e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit




Niveli i angazhimit me punonjës të pyjeve në BE (27 vendet mesatare) është 3¹⁵ të punësuar për 1,000 ha pyje (ku përfshin të punësuar në sektorin pyjor jo vetëm administratën publike). Ky tregues është 3.4 për Serbinë, 1.9 për Maqedoninë e Veriut dhe 0.34 për Malin e Zi.

Mbrojtja nga zjarri

Analiza e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSh) përfshin dy tregues kryesorë: **i)** numrin e zjarrfikësve për çdo 1,500 banorë dhe **ii)** numrin e automjeteve zjarrfikëse për çdo 10,000 banorë. Në vitin 2024 në nivel kombëtar, ka më pak se 1 zjarrfikës për 1,500 banorë dhe 1 automjet për 10,000 banorë (niveli pothuajse i njëjtë ky me vitin 2023).


GRAFIKU 28: TRENDI I TREGUESVE TË MZSH-VE, 2023-2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Treguesi zjarrfikës për çdo 1,500 banorë¹⁶, ndihmon në vlerësimin e kapaciteteve njerëzore për përballimin e emergjencave civile. Nevoja për të zbatuar standardin minimal të numrit të punonjësve bën që bashkitë e vogla të kenë më shumë zjarrfikës për frymë sesa bashkitë e mëdha.

GRAFIKU 29: NUMRI I ZJARRFIKËSVE DHE MJETEVE PËR BANORË, 2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

¹⁵ https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Forests,_forestry_and_logging

¹⁶ Të dhënat përfshijnë numrin e mjeteve zjarrfikëse funksionale (jo jashtë përdorimi) në zotërim të bashkisë dhe të regjistruara zyrtarisht për qëllime ndërhyrjeje emergjente.




Tirana ka numrin më të ulët të zjarrfikësve dhe automjeteve zjarrfikëse për frymë edhe pse ajo ka 3 stacione për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi. Kjo situatë është si rrjedhojë e densitetit të lartë të banimit, pallatet e larta, trafik të rënduar, objektet kritike (qendra tregtare, spitale, institucione qendrore).

Gjatë një dekade në menaxhimin e këtij funksioni bashkitë kanë përmirësuar ndjeshëm këtë shërbim. Numri i punonjësve që ata morën në vitin 2016 nga Ministria e Brendshme ishte vetëm 739 punonjës në total për të gjitha bashkitë, në 1,371 punonjës në 2024. Rritja nga 0.38 zjarrfikës/1,500 banorë që ishte në vitin 2015 në 0.86 zjarrfikës¹⁷/1,500 banorë në vitin 2024 (mesatare kombëtare) tregon seriozitetin me të cilin e morën këtë përgjegjësi bashkitë duke financuar pagat e punonjësve shtesë nga buxheti i tyre. Sot ky tregues është shumë afër nivelit mesatar të këtij treguesi në 27 vendet e BE-së (rreth 0.81¹⁸).

Treguesi i automjeteve zjarrfikëse për 10,000 banorë reflekton aftësinë logjistike të bashkive për të përballuar situatat emergjente dhe për të ofruar shërbimin në mënyrë sa më efikase. Vendet e BE e përdorin këtë tregues për të parë nëse ka mjaftueshëm automjete për popullsinë varësisht nga karakteristikat e bashkisë si: pyje, densiteti urban, distanca gjeografike etj.

GRAFIKU 30: TRENDI I AUTOMJETEVE ZJARRFIKSE, 2024



Për shembull Gjermania dhe Austria kanë norma të tilla si: 1 automjet për 800 – 2,000 banorë në zonat rurale dhe 1 automjet për 500 – 1,000 banorë për zonat urbane dhe ato me densitet të lartë.

Trendi në rënie tregon daljen nga shfrytëzimi i automjeteve për shkak të vjetërsisë së tyre. Kjo ngre një alarm për menaxherët vendorë për të marrë masa për investime në mjete, veshje dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme.

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Për shkak të efekteve të ndryshimit të klimës përgjatë viteve të fundit, vendi është përballur me shtimin e numrit të fatkeqësive natyrore, gjë që kërkon reflektim nga struktura e MZSH në territor për t'ju përgjigjur situatave në mënyrë eficiente.

¹⁷ Duhet theksuar se numri i punonjësve për MZSh në këtë raport llogarit gjithë numrin e punonjësve të stacionit MZSh për rastin e bashkive shqiptare (që jo domosdoshmërisht është zjarrfikës profesionist) ndërkohë që numri i zjarrfikësve në 27 vendet e BE-së i referohet vetëm atyre profesionist.

¹⁸ Nuk ka një raport zyrtar për këtë shifër por ajo është llogaritur si raport i numrit total të punonjësve zjarrfikës në 27 vendet e BE-së dhe numrit total të popullsisë në të gjitha këto vende së bashku.

MIRËQEVERISJE

Water quality and
wastewater infrastructure
Infrastruktura e cilësisë së
ujit dhe ujërave të zeza

Biodiversity and
green spaces
Biodiversiteti dhe hapësirat
e gjelbra

Renewable energy and
decarbonisation
Energjia e rinovueshme
dhe Dekarbonizimi

Energy and
climate efficiency
Efikasiteti i energjisë dhe
klimës

Air quality
Pollution reduction
Cilësia e ajrit
Reduktimi i ndotjes

Circular economy
and material reuse
Ekonomia qarkulluese dhe
ripërdorimi i materialeve

Climate adaptation
and disaster resilience
Përshtatja klimatike dhe
rezistenca ndaj katastrofave

Sustainable food
systems and rural
development
Sistemi i ushqimit dhe
zhvillimi rural

Fair wages and
decent work
Paga të drejta dhe
punë e drejtë

Youth retention
migration reduction
Mbajtja e të rinjve
reduktimi i migra

Transparency and anti
corruption
Transparenca dhe
antikorrupsioni



Mirëqeverisja, 2024


Burimet njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore në bashkitë e vendit mbetet një nga faktorët përcaktues për cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike dhe kapacitetin institucional të vetëqeverisjes vendore. Përtej rekrutimit të stafit, sfida kryesore lidhet me sigurimin e qëndrueshmërisë së personelit, zhvillimin profesional dhe përshtatjen e aftësive me nevojat në rritje të komuniteteve.

Administrata vendore i nënshtrohet rregullave të shërbimit civil shqiptar, të rregulluar nga Ligji nr. 152/2013, si dhe Kodit të Punës, i cili synon garantimin e një administrate profesionale, bazuar në meritë dhe politikisht asnjansë. Vlerësimi i vitit 2024 mbi rotacionin e punonjësve, përfshirjen në programe trajnimi dhe raportin punonjës për 1,000 banorë (Grafiku 31) tregon dallime të qarta të performancës midis bashkive sipas madhësisë së tyre, duke reflektuar kapacitetet menaxhuese, ngarkesat operationale dhe mjedisin e tregut të punës.

Në nivel kombëtar, krahasuar me 2023, shënohet një stabilizim i rotacionit (-0.5 pp) dhe një rritje e përfshirjes në trajnim (+3.9 pp), ndërsa raporti punonjës për 1,000 banorë është rritur në mënyrë të moderuar (+8.1 %), duke treguar përforsim të kapaciteteve institucionale në disa bashki.

GRAFIKU 31: BURIMET NJERËZORE, 2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Shkalla e rotacionit të punonjësve

Mesatarja kombëtare e rotacionit për vitin 2024 është 10 për qind, duke shënuar një ulje të lehtë nga viti i kaluar dhe reflektuar një stabilizim të vijimësisë në administratë. Bashkitë e vogla kanë një nivel rotacioni pranë mesatares (9.3 për qind), ndërsa bashkitë e mesme shfaqin rotacion më të lartë (11 për qind), çka mund të lidhet me kontrata afatshkurtra, dinamika të brendshme organizative ose lëvizshmëri më të madhe të stafit.

Bashkitë e mëdha me 50,000–150,000 banorë dallohen me nivelin më të ulët të rotacionit, vetëm 7.6 për qind, çka tregon stabilitet institucional dhe aftësi për të mbajtur personelin. Ky stabilitet ka ndikim pozitiv në ruajtjen e kujtesës institucionale dhe në cilësinë e shërbimeve. Tiranës i atribuohet një nivel më i lartë rotacioni (13 për qind), që mund të shpjegohet nga tregu konkurrues i punës dhe mobiliteti i stafit midis institucioneve publike dhe sektorit privat. Këto

të dhëna dëshmojnë nevojën për politika më të forta të qendrueshmërisë së personelit, sidomos në bashkitë mesatare dhe në ato me konkurrencë të lartë të tregut të punës.



GRAFIKU 32: SHKALLA E ROTACIONIT 2023 - 2024


Përsa i përket krahasimit me vitin e kaluar, mesatarja kombëtare e rotacionit të punonjësve në vitin 2024 krahasuar me 2023 ka rënë me 0.47p.p.

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Përqindja e stafit të trajnuar

Mesatarisht, 12.9% e stafit në rang vendi është përfshirë në trajnim gjatë vitit 2024, duke shënuar një rritje prej rreth +3.9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023 (shih Grafikon 33). Ky progres tregon se bashkitë po i kushtojnë gjithnjë e më shumë rëndësi zhvillimit profesional dhe cilësisë së burimeve njerëzore.

GRAFIKU 33: SHKALLA E TRAJNIMIT TË STAFIT NË BASHKI



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Dinamika ndryshon ndjeshëm sipas madhësisë së bashkisë. Bashkitë e vogla qëndrojnë pak mbi mesataren kombëtare, ndërsa bashkitë mesatare dhe të mëdha kanë përqindje më të ulëta të trajnimit (8.6% dhe 8.4% përkatësisht). Bashkitë me popullsi më të lartë kanë ende nevojë të rrisin investimet në zhvillimin e stafit, sidomos në fusha teknike dhe procese që lidhen me digjitalizimin.


Tirana shfaq një përfshirje shumë më të lartë në trajnim (26.6%), duke reflektuar burime financiare më të konsiderueshme dhe ekzistencën e programeve të strukturuar të zhvillimit të burimeve njerëzore.

Në tërësi, rritja e përfshirjes në trajnim në vitin 2024 dëshmon një zhvendosje pozitive drejt profesionalizimit të administratës vendore. Sfidë mbetet shtrirja e barabartë e mundësive për trajnim, sidomos në bashkitë me kapacitete të kufizuara dhe staf të pakët, të cilat kanë më shumë nevojë për mbështetje të synuar për të forcuar performancën institucionale.

Punonjës për 1,000 banorë

Ky tregues varion ndjeshëm midis bashkive. Bashkitë e vogla kanë raport shumë të lartë (36.74), për shkak të nevojës për prezencë fizike në territor, profilin dhe llojin të shërbimeve që kërkojnë burime të dedikuara. Bashkitë mesatare dhe të mëdha kanë një raport dukshëm më të ulët (21.03 dhe 15.09 përkatësisht), duke treguar efikasitet më të lartë, automatizim më të madh të proceseve dhe shpërndarje të optimizuar të stafit. Tirana ka raportin më të ulët (14.74), çka tregon ngarkesë të lartë për punonjës dhe një administratë të orientuar drejt teknologjisë dhe sistemeve të integruara të menaxhimit.

GRAFIKU 34: PUNONJËS PËR 1000 BANORË, 2023-2024



Vlerësimi për 2024 tregon se ka një rritje të raportit të stafit për 1,000 banorë (rreth +8.2 për qind) krahasuar me vitin 2023, që mund të nënkuptojë shtim të kapaciteteve në njësi të caktuara ose rishpërndarje të brendshme të roleve.

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Analiza e vitit 2024 tregon se bashkitë e mëdha pozicionohen qartë si grupi me përparësitë më të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve njerëzore. Avantazhet e tyre kryesore janë:

- **Stabilitet institucional:** niveli më i ulët i rotacionit në rang kombëtar sinjalizon mjedis pune më të qëndrueshëm, kualifikim të punonjësve dhe cikle të konsoliduara rekrutimi.
- **Administratë më e profesionalizuar:** kuadri i gjerë i shërbimeve urbane kërkon staf me aftësi më të specializuara, duke krijuar një administratë me kapacitete të mëdha teknike dhe operacionale.
- **Efikasitet më i lartë strukturor:** raporti më i ulët i stafit për 1,000 banorë tregon nivel më të lartë digjitalizimi, racionalizim të proceseve dhe përdorim më strategjik të personelit.
- **Elasticitet organizativ:** bashkitë e mëdha kanë kapacitete për të menaxhuar sfida si ndryshimet në kërkesën për shërbime, rritjet e popullsisë dhe tranzicionet teknologjike pa krijuar luhatje të mëdha në performancë.



Këto përparësi i vendosin bashkitë e mëdha në pozicion më të favorshëm për të përballuar kërkesat e qeverisjes moderne, për të zbatuar politika afatgjata dhe për të garantuar cilësi të lartë të shërbimeve publike.

Në përfundim: Të dhënat e vitit 2024 tregojnë një panoramë të pabarabartë të menaxhimit të burimeve njerëzore midis bashkive në Shqipëri. Ndërsa niveli kombëtar shënon stabilizim të rotacionit dhe rritje të përfshirjes në trajnim, bashkitë e vogla mbeten të mbingarkuara në raport me stafin dhe të ekspozuara ndaj luhatjeve të personelit. Bashkitë mesatare tregojnë potencial, por përballen me rotacion më të lartë dhe përfshirje më të ulët në trajnim. Në kontrast, bashkitë e mëdha dallohen për stabilitet më të madh, efikasitet strukturor dhe administratë më të profesionalizuar.


Transparenca dhe llogaridhënia

Viti 2024 shënon një fazë të rëndësishme të konsolidimit të mekanizmave të mirëqeverisjes në nivel vendor, duke reflektuar zgjerimin e kuadrit të transparencës, llogaridhënies dhe forcimit institucional. Në krahasim me vitin 2023, ku vlerësimi i qeverisjes dhe transparencës u mbështet kryesisht në indikatorë të tillë si publikimi online i vendimeve të Këshillave Bashkiakë dhe përqindja e projekt-akteve të detyrueshme për t'u përfshirë në konsultim publik, në vitin 2024 janë shtuar indikatorë të rinj të rëndësishëm që synojnë rritjen e standardeve të përgjegjshmërisë dhe integritetit në nivel bashkie. Këta indikatorë të rinj janë:

- Publikimi i Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024–2026.
- Publikimi i Paketës Fiskale 2024.
- Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes.

Shtimi i indikatorëve të rinj ka lejuar një vlerësim më të plotë institucional, duke kaluar nga matja e elementeve bazë drejt një sistemi më të thelluar dhe të qëndrueshëm të transparencës dhe llogaridhënies. Vlerësimi i rezultateve sipas grup - bashkive paraqet qartë modelet e performancës dhe sfidat strukturore (Figura 22)

GRAFIKU 35: TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA, 2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV



Bashkitë deri në 10,000 banorë tregojnë se transparenca ekziston, por mekanizmat e avancuar të llogaridhënies duhen përmirësuar. Ky grup shfaq nivelet më të ulëta të transparencës në pothuajse të gjithë indikatorët (52.5 për qind e akteve të konsultuara publikisht; 0.2 treguesi i raportit vjetor të transparencës; 0.9 treguesi i publikimit të vendimeve të këshillit bashkiak; publikimi i PBA-së është 0.2; publikimi i paketës fiskale vlerësohet 0.5). Vlerësimi i të dhënave tregon se bashkitë e vogla kanë sfida strukturore të cilat mund të lidhen me sfida kapacitetsh dhe ekspertizash teknike në hartimin e dokumenteve strategjike.

Gjithashtu, vlerësimi tregon se bashkitë me 10,000 - 50,000 banorë paraqesin rritje në performancë, por ende të pamjaftueshme në krahasim me kërkesat e reja të transparencës. Përqindja e akteve të konsultuara (55.2 %) dhe publikimi i raportit vjetor të transparencës (0.3) tregojnë përmirësim të moderuar. Publikimi i PBA-së (0.6) dhe Paketës Fiskale (0.7) reflekton rritjen e kapaciteteve për transparençë fiskale, ndërsa publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak (0.9) mbetet brenda standardeve të mira. Bashkitë mesatare kanë kapacitete më të mira se ato të vogla dhe po përshtaten me indikatorët e rinj, por hendeuku me standardin e plotë të transparencës vazhdon të jetë prezent.

Bashkitë e mëdha (50,000–150,000 banorë) shfaqin performancën më të qëndrueshme dhe përfaqësojnë praktikën më të mirë në nivel kombëtar. Analiza e treguesve tregon se këto bashki gëzojnë një sërë përparësish strukturore dhe institucionale që i vendosin ato në avantazh të dukshëm ndaj bashkive të vogla dhe mesatare.

Në përfundim, transparenca dhe llogaridhënia në qeverisjen vendore janë në rritje, por kërkojnë një qasje të diferencuar, ku bashkitë me kapacitete të kufizuara mbështeten më shumë për të siguruar barazi në zbatimin e standardeve të qeverisjes së hapur në të gjithë territorin. Bashkitë e mëdha (50,000–150,000 banorë) ofrojnë modelin më të mirë të qeverisjes së hapur, duke demonstruar stabilitet, standardizim dhe kapacitete të plota për të përmbushur kërkesat e indikatorëve të rinj.

Integrimi Evropian

Viti 2024 shënon përfshirjen më të gjerë të një seksioni të dedikuar për integrimin evropian në vlerësimin e performancës së bashkive, duke theksuar rolin gjithnjë e më të rëndësishëm që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë në procesin e integrimit evropian.


Për këtë qëllim, në vitin 2024 janë prezantuar pesë tregues të rinj që matin dimensione thelbësore të qeverisjes lokale në kontekstin e integrimit evropian. Këta tregues përfshijnë: numrin e marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara, ngritjen dhe funksionimin e strukturave të performancës sipas Manualeve Orientuese të AMVV, raportin mes projekteve të fituara dhe atyre të aplikuara nga fondet e BE-së për periudhën 2023–2024, hartimin e Planeve të Migracionit dhe Diasporës, si dhe ngritjen e Komisioneve të Integrimit Evropian pranë këshillave bashkiakë.

Në tërësi, vlerësimi ndihmon të kuptohen më mirë përpjekjet e bashkive për të krijuar struktura të brendshme funksionale, për të zhvilluar partneritete të reja institucionale dhe për të siguruar që procesi i integrimit të shndërrohet në praktikë të përditshme të qeverisjes vendore. Të dhënat e vitit 2023–2024 tregojnë se bashkitë në Shqipëri demonstrojnë nivele të ndryshme angazhimi



në bashkëpunimin ndërbashkiak dhe në aplikimet për fonde evropiane, dy dimensione thelbësore të integritit në nivel vendor (Figura 23).

GRAFIKU 36: INTEGRIMI EVROPIAN , 2024



**Mesatarja e Marxhinalizuar nuk përfshinë bashkitë që nuk kanë marrëveshje ndërbashkiake*

Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Në nivel kombëtar, bashkitë kanë nënshkruar mesatarisht 1.10 marrëveshje ndërbashkiake, ndërsa norma e suksesit të projekteve të fituara kundrejt atyre të aplikuara arrin në 36.43 për qind. Mesatarja e Marxhinalizuar (2.39) tregon se një pjesë e bashkive po investojnë më shumë në partneritete horizontale, ndërsa pjesa tjetër mbetet ende në faza të kufizuara bashkëpunimi.

Bashkitë e vogla deri në 10,000 banorë kanë numrin më të ulët të marrëveshjeve, por ruajnë norma të mira suksesi të projekteve evropiane, si rezultat i aplikimeve më të targetuara. Bashkitë me 10,000–50,000 banorë paraqesin nivelin më të lartë të bashkëpunimit ndërbashkiak dhe tregojnë aftësi të strukturuar në sigurimin e projekteve të financuara. Bashkitë me 50,000–150,000 banorë mbajnë një pozicion me normë të qendrueshme suksesi dhe aftësi të konsoliduara për të zhvilluar projekte të BE-së dhe partneritete institucionale. Tirana paraqet një profil të veçantë me nivel shumë të lartë suksesi në projektet e BE-së, por me numër më të ulët marrëveshjesh ndërbashkiake, duke reflektuar fokus në bashkëpunime të drejtpërdrejta me institucionet evropiane.

Në mënyrë të veçantë, bashkitë e mëdha 50,000–150,000 banorë dallohen për kapacitete të qendrueshme në hartimin e projekteve, aftësi konkurruese për të siguruar financime, dhe potencial të lartë për bashkëpunime ndërkombëtare.

Në përfundim, të dhënat e treguesve të integritit evropian tregojnë se bashkitë kanë bërë hapa përpara, por mbeten në nivele të pabarabarta përgatitjeje. Bashkitë duhet të fokusohen në forcimin e kapaciteteve teknike për hartimin e projekteve, zgjerimin e bashkëpunimit ndërbashkiak dhe krijimin e strukturave funksionale të integritit brenda këshillave bashkiakë. Rritja e profesionalizimit, koordinimi më i mirë institucional dhe përfshirja më aktive në programet e BE-së janë elementët kryesorë që do t'i mundësojnë bashkive të rrisin performancën dhe të kontribuojnë më fuqishëm në procesin e integritit evropian në nivel lokal.




Barazia gjinore

Në përputhje me parimet e Ligjit “Për Barazinë Gjinore” (2008), vlerësimi i vitit 2024 synon të evidentojë sa hapësirë u krijohet grave për të marrë role vendimmarrëse dhe menaxheriale brenda qeverisjes vendore, si dhe sa të strukturuar janë politikat e brendshme për barazinë gjinore.

Të dhënat tregojnë se përqindja mesatare e grave në qeverisjen vendore është 33.70 % (Grafiku 37). Bashkitë më të mëdha, me 50,000–150,000 banorë, raportojnë përfaqësim më të lartë me 39.66 %. Një tendencë e ngjashme vërehet në Tiranë, e cila regjistron 39.71 % gra në poste vendimmarrëse. Bashkitë më të vogla dhe ato me zhvillim ekonomik të kufizuar paraqesin përfaqësim dukshëm më të ulët, duke treguar vështirësi të vazhdueshme në sigurimin e diversitetit gjinor në administratë.

GRAFIKU 37: BARAZIA GJINORE, 2024



Burimi: NJVV dhe llogaritje nga AMVV

Rezultatet sugjerojnë disa arsye të mundshme për këto diferenca. Në bashkitë më të vogla, sfidat e burimeve financiare dhe administrative, tregu më i kufizuar i punës, si dhe pjesëmarrja më e ulët e grave në pozita profesionale me potencial drejtues, ndikojnë në krijimin e një kategorie më të ngushtë kandidatësh femra për pozita të larta. Bashkitë e mëdha përfitojnë nga tregu më i gjerë i punës, akses më i madh në programe të formimit profesional dhe struktura të brendshme më të standardizuara për menaxhimin e karrierës.

Sa i përket pozicioneve drejtuese, përfaqësimi i grave mbetet më i lartë në bashkitë me mbi 50,000 banorë, ku 51.5 % e posteve të ulëta dhe të mesme drejtuese mbahen nga gra. Në Tiranë, ky tregues arrin 50.55 %, duke treguar struktura institucionale që sigurojnë mundësi më të barabarta avancimi. Bashkitë e vogla dhe të mesme raportojnë nivele më të ulëta të përfaqësimit, çka mund të lidhet me mungesë specializimesh profesionale dhe rrjedhimisht më pak gra me eksperiencë të mjaftueshme për pozicione menaxheriale.

Krahasuar me vitin paraardhës, të gjitha grupet e bashkive paraqesin rritje të përfaqësimit të grave në çdo nivel drejtues. Kjo rritje sugjeron se politikat e barazisë gjinore, programet kombëtare të fuqizimit të grave dhe ndryshimet graduale kulturore po japin efekte të matshme në qeverisjen vendore. Megjithatë, diferencat e dukshme ndërmjet bashkive të vogla dhe të



mëdha tregojnë se ndikimi i këtyre politikave është i pabarabartë, duke reflektuar dallimet e përgjithshme ekonomike, demografike dhe institucionale.

Në përfundim, vlerësimi i vitit 2024 konfirmon se ndërsa barazia gjinore në qeverisjen vendore ka shënuar progres, ajo mbetet e fragmentarizuar dhe e lidhur ngushtë me kapacitetet strukturore të bashkive, madhësinë territoriale dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik.



Sfida dhe Rekomandime

Nga analiza në vitin 2024, konstatohet ruajtja e trendit të përmirësimit të performancës jo vetëm në burimet e financimit dhe zbatimin e shpenzimeve, por edhe në cilësinë e shërbimeve publike dhe në mekanizmat e mirëqeverisjes. Ky progres reflekton një forcim gradual të tre shtyllave themelore të funksionimit të bashkive: **qëndrueshmërisë financiare, cilësisë së shërbimeve dhe konsolidimit institucional në mirëqeverisje.**

